

## **GAJUR DERALLA: “KOMANDIMI IM I SHKURTËR ME BATALIONIN E TRUPAVE TË RREGULLTA TË USHTRISË SHQIPTARE PAS KAPITULLIMIT TË ITALISË”<sup>789</sup>**

**Qerim LITA**

Në prag të kapitullimit të Italisë isha me detyrë zyrtare në Prishtinë, si komandant i shkollës së porsaformuar të nënoficerëve. Po atë natë kur u shpall kapitullimi, sa më kujtohet, shpallja ishte në mesnatë, data nuk më kujtohet. Në Radio-Stamboll dëgjova se Italia ka kapitulluar, duke e tradhtuar aleatin e saj, Gjermaninë, u është dorëzuar anglo-amerikanëve, ngase ushtria mbretërore italiane, përveç trupave fashiste që u janë bashkangjitur gjermanëve dhe çarmatoset nga gjermanët, ndërsa anglo-amerikanët në përparimin e tyre shkojnë me një temp të përshpejtuar pa pasur para vetes rezistencë.

Kuptohet, në atë rast nuk mund të isha pasiv, por fillimisht e kërkova majorin Jusuf Gjul Beun, komandantin e batalionit shqiptar në

---

<sup>789</sup> Nisur nga fakti se historiografia shqiptare fare pak është marrë me këtë njësi ushtarake, e pamë të arsyeshme që punimit studimor t’ia bashkëngjitem dokumentin me titull “Komandimi im i shkurtër me Batalionin e Trupave të Rregullta të Ushtrisë Shqiptare”, përkatësisht rrëfimin e Gajur Beut dhënë para organeve të hetuesisë. Në të, veç tjerash, në mënyrë autentike e përshkruan situatën e krijuar pas kapitullimit të Italisë; largimin e tij nga ushtria dhe takimin me parinë e Tetovës; kërkesën e kësaj të fundit për themelimin e batalionit; takimet e shumta me krerët politikë e ushtarakë të mirënjohur, siç ishin Shaip Kamberi, Baba Qazimi, Nexhmedin Besimi, Mentor Qoku, Xhemë Gostivari, Ali Shefqet Shkupi, Pajazit Boletini etj.; shkuarjen e tij e të parisë së Tetovës, Gostivarit, Kërçovës e të Strugës në Tiranë dhe takimin me Mehdi Frashërin; themelimin e batalionit Luboten dhe jehona te masat e gjera shqiptare; qëndrueshmërinë e tij dhe bashkëluftëtarëve të tij që batalionin mos ua dorëzojnë disa oficerëve të dirigjuar nga Tirana; përpjekjet e tij për organizimin ushtarak në tokat shqiptare nën zonën pushtuese bullgare; refuzimin që të luftojë kundër njërive partizane në Pogradec; internimin e tij e të vëllait nga ushtria gjermane; kthimi nga internimi dhe burgosja nga ushtria jugosllave etj.

divizion, mirëpo edhe ai vetëm se e kishe dëgjuar, madje edhe oficerët tjerë, të cilët komandonin me njësi më të vogla, ishin të njoftuar rreth ngjarjes. Në këtë mënyrë, lajmi u përcoll deri te ndihmës komandanti i divizionit, major Rexhep Gjilani, dhe për një kohë të shkurtër pas lajmeve të radios, pa munguar asnjë oficer, u gjetëm brenda kazermës te majori Rexhep Gjilani dhe majori Jusuf Gjil Beu.

Major Gjilani me zë të ashpër, duke na u drejtuar neve urdhëroi si vijon: “Ngjarjen e dini, nuk është kurrfarë loje, nga veprimi ynë i tanishëm padyshim se do të varet e ardhmja e atdheut tonë. A e kuptuat, Italia, në çfarë do pozite që të jetë, nesër apo pasnesër, por jo deri në një kohë të pacaktuar, por në një të ardhme të afërt, mund të jetë edhe më e fuqishme, ndërsa për robërinë e saj të mos ëndërrojë askush, sepse ajo veten do ta çlirojë. Unë ju bëj apel, të jeni të durueshëm dhe të mos llogarisni te italianët, prandaj nuk do t’i lëmë të largohen me armatimin e tyre. Prandaj, me një shpejtësi më të madhe dhe pa zhurmë përgatitni njësitë, që nën armë të jenë të gatshëm për çdo eventualitet, që mund të shpërthejë në çdo moment nga cilado anë qoftë, madje edhe në këtë moment, duke mos pasur aspak frikë, unë jam në pritje të asaj ngjarjeje që do të mund të na befasonte, por nuk do të lejojmë. Urdhër plotësues do t’u dërgoj oficerëve dhe nënoficerëve. Për momentin, shkollën e nënoficerëve nën komandën e kapitenit Gajur Deralla e vendos nën disponimin tim si njësi rezerve”.

Vetëm 45 minuta pasi e zura pozicionin, ai e vendosi në komandë të divizionit adjutantit e porsazgjedhur, kapitenin Aqif Dibrën. Në kalim e sipër më tha se njësitë i kanë zënë pozicionet e tyre. Pas një kohe të shkurtër, kapiteni Aqif Dibra doli dhe më tha se komandanti është dorëzuar dhe se nuk përgjigjet për pasojat, prite urdhrin tjetër. Tash për tash çarmatose çetën e xhandarmërisë italiane, si dhe artilerinë italiane e cila gjendet në perëndim të tyrbes së Sulltan Muratit, në hyrje të Prishtinës.

Siç na u tha, se do t'i çarmatosim italianët në mënyrë grupore e individuale, unë atë ua përcolla komandantëve të çetave dhe oficerëve të kompanive, të cilët detyrën e kryenin, mirëpo në mungesën time, major Gjilani e kishte parë togerin Mehmet Saliun që çarmatoste dhe armatimin ua jepte civilëve, madje kërkonte sqarim përse të dorëzojë armatimin. Toger i është përgjigjur se ka marrë urdhër nga unë, komandanti i shkollës. Posa u ktheva nga çarmatosja, më pyeti ai se në bazë të çkahit kam shpërnda armatim, ndërkohë pa u menduar fare iu përgjigja se kam shpërndarë në bazë të urdhrit tuaj, sepse ai në mbledhjen e parë të gjithë oficerëve ua përcolli dëshirën e Mehdi Frashërit si vijon: "Duke i ruajtur njësitë e rregullta, si dhe aradhet vullnetare, në të ftohen njerëzit e aftë, të cilët mund të jenë drejtues të çetave dhe t'u dorëzohet armatimi që do të merrej nga italianët, ndërsa tjetra të vendoset nëpër depo.

Me themelimin e çetave të reja, si dhe me fuqitë ekzistuese t'u kundërvihemi edhe gjermanëve, nëse paraqitet nevoja, përkatësisht nëse për këtë merret urdhri". Unë jam vetëm përcjellës i urdhrit tuaj. Përndryshe, edhe ashtu ka ardhur koha që kjo të kryhet. Të gjithë oficerët që ishin prezent deklaruan se të shpërndahet armatimi në numër të pacaktuar. Komandanti i divizionit u deklarua pozitivisht, por gjermanët ishin në rrugë për në Prishtinë, atëherë kush do të përgjigjet nëse na e kërkojnë armatimin. Të gjithë njëzëri ia kthyem përgjigjen: "Le të përgjigjen pushkët tona!", nëse ata marrin guximin të na çarmatosin. Pas kësaj, çarmatosja e italianëve, si individualisht ashtu edhe në grup zgjati 5 ditë dhe ne gjatë këtyre 5 ditëve kemi shpërndarë armatim, duke ua dhënë krerëve të çetave, të emëruar nga komiteti në Prishtinë, ndërsa kryetar i komitetit njëkohësisht edhe nënkryetar i komunës ishte Hysen Xhemal Prishtina, djali i Xhemal Beut nga Prishtina, dhe dhëndër italian. Depot e armatimit ishin në duart e mia, kështu që vetëm unë kam shpërndarë më shumë se 2.800 pushkë dhe 1.000 arka municion.

Megjithëse në ditën e parë dyshuam se gjermanët janë nisur për në Prishtinë nga drejtimi i Mitrovicës së Kosovës, ata erdhën tek ditën e nesërme, rreth 1.500 me automobila, duke e zënë pozicionin në mes të oborrit nën shatorë, duke mos ndërmarrë asgjë kundër nesh (mendoj të na çarmatosnin). I lidhën italianët, ndërsa nga ne nuk kërkuam as armatimin. Rexhep Gjilani u takua me gjermanët, me atë rast pashë edhe prefektin dhe kryetarin e komunës të sipërpërmendur, dhe major Agushin që me komandantin gjerman, i cili qe dërguar nga Pajazit Buletini, të qeshnin këndshëm. Pasi i përcolli komandantin gjerman dhe Nijazi Agushin, u kthye në kazermë, ku me urdhrin e tij sërish të gjithë oficerët duhej të tuboheshim. Filloi të flasë vetë komandanti, Rexhep Gjilani: “Përfundimisht erdhën gjermanët, armatimin nuk na e morën, madje as nga depot tona. Se si do të zhvillohet situata më tej për momentin nuk e di, mund t’ju them se krahas radio-stacionit dhe telefonit nuk kam as çfarë lidhje me Tiranën, për shkak se nuk kemi specialistë për radio, ndërsa lidhjet telefonike janë ndërprerë për shkak luftimeve që po i zhvillon Muharrem Bajraktari në Kukës, me dëshirën që të çarmatosë një njësi italiane. Nëse do të vendosim lidhjet do ta kishim lehtë, kështu të shohim se çfarë do të ndodhë me Mehdiun, sepse i kanë ofruar pozicionin më të lartë. Ju qëndroni në njësitë”.

“Nëse dëshirojnë të na çarmatosin, çfarë të bëjmë?”, pyeti major Gjil Beu.

“Deri te kjo nuk do të vijë!”, iu përgjigj komandanti.

Unë e plotësova – “A thua Mehdiu mund të pranojë një detyrë të tillë? A ka mundësi edhe Mitati dhe a thua nuk do vijë momenti i fundit?”

Përgjigjja e komandantit ishte se “momenti i fundit do të vijë, Mitati nuk do ta pranojë detyrën, ndërsa Mehdiu e ka pa tjetër të flijohet, si duket situata është e tillë”.

Pas gjysmë ore u kthye sërish, tashmë ishim vetëm unë dhe Gjil Beu, dhe na njoftoi: “Më lajmëruan se Mehdiu ka vendos ta pranojë detyrën e

kryetarit – “të Këshillit Suprem”, me të do jenë edhe Pjetër Anton Arapi dhe Lef Nosi, prandaj ne ngelim legalë. Tash për tash lajmëroni oficerët tuaj, kujdesuni që vetvetiu të mos ndërmarrin asgjë, sepse nuk do të kenë ndikim te ushtarët. Janë të tjerë ata që këtu kanë ndikim e jo ne, nëse diçka do të bëhet mundet vetëm në marrëveshje”.

Atëherë ai, në radhë të parë mendonte për Iliaz Agushin, Iliazi së shpejti shkon për Tiranë për t’u takuar me Mediun. Në një gjendje të këtille e kaluam edhe ditën e tretë e deri në ditën e pestë, kur gjermanët sulmuan depot. Fillimisht morën uniformat dhe ua shpërndanin shqiptarëve, të cilët me siguri se vetëm ata i njihnin, dhe pasdite u përpoqën të marrin armatimin dhe municionin, por roja nuk i lejonte. Erdhi deri te ajo që të intervenojë komandanti i divizionit, major Gjilani, duke urdhëruar që “ushtrisë gjermane t’i plotësohet dëshira”. Më ftuan mua dhe ma morën çelësin, me çka morën sa deshën armatim. Gjilani duke harruar atë se çfarë kishte deklaruar më herët, m’u drejtua duke më thënë: “Kështu duhet, më beso!”. Isha i gëzuar që tashmë gjysmën e pata shpërndarë. Nuk më ngeli asgjë tjetër vetëm se të largohem, sepse ishte më se e qartë se më nuk isha komandant, por një kukull më i thjeshtë në duart e të besuarit të Iliazit (Agushit-Q.L.).

Njëllor që edhe me shokët, të cilët e lëshuan komandën pa pëlqim. Në atë kohë, në Prishtinë filloi të bëjë gjithçka një ish-nëpunës i hekurudhës jugosllave, i cili pa as çfarë përgatitje profesionale filloi të komandojë edhe me mua, prandaj lëshova Prishtinën dhe ditën e gjashtë isha në Prizren, ku u ndala për të kuptuar diçka rreth Mehdiut, Mitatit e të tjerëve, të cilët na mbanin neve deri në momentin e fundit, se nuk ka ardhur ende koha, sepse humbjet do të ishin të paparashikuara.

Iliaz Agushi, të cilin kolonelët italianë e pritën në Prishtinë me muzikë dhe me gardën ushtarake, tash gjermanët e bënë edhe më të besueshëm, prandaj ishte e kotë të pritej ndonjë përmirësim. Me ne filluan të komandojnë ushtarët tanë dhe prindërit e vëllezërit e tyre, të

besuarit e Iliazit, kurse shtëpia e tij ishte vendtakimi i gjermanëve me të afërmit e tij.

Gjatë ardhjes në Prizren takova aty komitetin e porsaformuar dhe anëtarët e Komitetit Vendor të Tetovës, Gostivarit e Kërçovës (Komiteti i Lidhjes II të Prizrenit për qarkun e Tetovës, ku përfshihej edhe Gostivari e Kërçova – Q. L.), të cilët kishin ardhur në Kongresin e Lidhjes II të Prizrenit. Anëtarët e pjesëtarë të Komitetit të Tetovës ishin këta personalitete: Baba Qazimi, Sherif Mina, Ahmet Efendiu dhe Nexhmedin Besimi, si sekretar i Komitetit, dhe Hysen Deralla si kryetar i Komitetit, të cilët kishin ardhur në cilësi të delegatëve në Prizren.

Takimi ynë papritmas ndodhi në tregun e qytetit dhe mua nga ana e Baba Qazimit, me ndërhyrjen e Nexhmedinit, filloi të më jepet leksioni patriotik me apel për ndjenjat e mia patriotike, jo në kuptimin e këshillave, por disi me kërcënime dhe ofendime të vogla.

Baba Qazimi më tha: “Me siguri vjen nga Prishtina?”

Unë menjëherë iu përgjigja se atë e kam bërë pa pëlqimin e askujt dhe se këtë që e kam bërë është mirë.

Baba Qazimi: “Së shpejti secili do të përgjigjet para gjyqit të atdheut të lirë për veprimet e tyre vetjake, veçmas intelektualët e në radhë të parë oficerët”.

Ky mendim ishte shprehur me bindje, se tashmë gjendem para një largimi të pamertuar nga njësitë e me qëllime të këqija ndaj atdheut. Duke ndërhyrë me zë të lartë, Nexhmedin Besimi e ndërpreu bashkëbiseduesin e tij, duke shtuar se “gjithsesi se përgjegjësia është tepër e madhe dhe se Gajuri për këtë me siguri se është i vetëdijshëm”.

Më pas m’u drejtua: “E ti trimi, vërtet nga po na vjen?”.

“Siç e dëgjove, nga Prishtina!”

Unë u gjeta para anëtarëve të komiteteve vendore të Tetovës, Kërçovës e të Strugës, e dija se shumica ishin ballistë. Veç kësaj Nexhmedini ishte sekretari i dytë i Kongresit të Lidhjes II të Prizrenit dhe përveç tij ishte edhe një gjilanas për mua i pa njohur, me prejardhje nga Tetova, me emrin Aqif Tetova /e dëgjova në kongres e më pas nuk e kam parë asnjëherë/, i cili ndërhyri në bisedë me fjalët: “z. Nexhmedin, koha është e mjegullt, z. kapiteni duhet të ketë ndonjë arsye, e veç të tjerash, mosmarrëveshje të tilla, në rrethana të këtilla, kemi shumë, nuk është i vetmi dhe shumica kryesisht mendojnë kështu. Mendoj se me bindje reciproke duhet të veprojmë. Mos harroni se rinia ndaj nesh ka dyshim, sepse mu në këto krahina kanë qenë të udhëhequr nga njerëz, të cilët e kanë ndërruar maskën dhe kanë shkuar te vëllezërit tanë andej kufirit, të cilët absolutisht nuk dinë asgjë se çfarë vuajtjesh kemi përjetuar nga viti 1912 e deri më tash. Jo, ne nuk jemi italianë e as gjermanë, ne nuk dëshirojmë që në shtëpitë tona të na qëndrojnë ndonjë si padron, apo aq më tepër jemi dakord për të kopjuar nga pushtuesit e egër”. Duke u larguar shtoi: “Më falni, unë jam i preokupuar me gjëra shumë më të rëndësishme”.

Posa u largua folësi, unë (Gajur Deralla–Q.L.), Baba Qazimit dhe Nexhmedinit iu përgjigja si vijon: “Ju të dy shumë jeni preokupuar pa ju autorizuar askush, ndërsa ti Nexhmedin nuk ke as çfarë të drejte për një qëndrim dhe kërcënim të tillë. Nëse sot unë jam oficer, ti je gjyqtar – aq më keq, ti je ai i cili dënon me ligjin e fashizmit, me ato ligje, siç tha Aqifi, që na janë imponuar me forcë, dhe si i ri me asgjë nuk na ke ngarkuar neve, sepse nuk i ke shërbyer atdheut aq sa unë i kam shërbyer, që menjëherë të fillosh të kërcënohesh. A je i bindur se rruga jote, përkatësisht e juaj është ajo që duhet shkuar? A di ti se çfarë di unë për gjendjen e mjerueshme të ushtrisë sonë? Unë të përgjigjem se nuk e di, edhe atë për ta lehtësuar, unë do të them jo për ta arsyetuar arratisjen, sepse nuk frikohem nga ty, e as që mundet dikush të më dënojë për këtë gjest, por ta dish të vërtetën, së paku që nesër të shpresojmë, e sot neve na ka ardhur një pushtues i ri dhe na dikton. Më

jepni mundësi që pas mbrëmjes t'i shtrojmë çështjet pa asnjë rezervë, ku dëshiroj të jenë prezent të gjithë. Nuk fola para Aqifit, për shkak se nuk e njihja”.

Me propozimin tim u pajtuan të gjithë, që në mbrëmje të mbajmë një konferencë me pjesëmarrjen e të gjithëve në hotelin “Çajtore”. Në atë mbledhje ishin prezent, nga Tetova: Baba Qazimi, Sherif Mina, përndryshe deputet i Tetovës, hoxha Ahmet Efendiu dhe Nexhmedin Besimi, ndërsa vëllai im Hysen Deralla, për shkaqe personale nuk mori pjesë, duke thënë se ai pajtohet me qëndrimin e Baba Qazimit dhe Sherif Minës; nga Gostivari: Kadri Saliu- përndryshe deputet nga Gostivari, Remzi Debreshi, gjithashtu deputet nga Gostivari dhe i riu Nexhmedini /mbiemri i të cilit nuk më kujtohet, përndryshe gostivaras, i cili kishte kryer shkollën e mesme tregtare në ish-Jugosllavi, asaj kohe shef i sektorit për financa, e tash diku në Amerikë;/ nga Kërçova: Shaban Efendiu, njëkohësisht deputet në Tiranë, ndërsa nga Struga: Remzi Beu, i quajtur i enciklopedia e kombit shqiptar. Atë e njihja shumë mirë që në kohën e luftës politike të partisë, me forcë të emërtuar Xhemijet dhe e njihja si një mendimtar i Nexhip Dragës, Ferat Dragës, Halim Derallës, Hamdi dhe Inajet Ohrit me shokë, të cilët që asaj kohe kërkonin kthimin e tokave shqiptare të konfiskuara me Reformën Agrare, të drejtën e shkollimit të shqiptarëve në gjuhën amtare, atë fillore e të mesme, si dhe ndërprerjen e shpërnguljes për në Turqi.

Kur në shtëpinë tonë, e cila tash është spital, e kritikoi në mbledhje bashkëmendimtarin e tij Ferat Dragën, për paraqitjen e tij tepër të nervozuar, kundër Ninçiqit /nëse nuk gaboj/, me atë rast Ferat Draga iu përgjigj Ninçiqit me nervozë: “Ne nuk do të presim derisa ju nuk i qetësoni shpirtrat në kuvendin kombëtar, gjendja e shpirtrave tuaj nuk na tangon neve, i kërkojmë të drejtat tona”, dëshmonin Ferat Draga së bashku me vëllanë tim.

Sipas Remzi Beut: “Në rastin e parë, shteti do të përpiqet që me çdo kusht t'i rrënojë, prandaj nuk është dashur atë ta bëjnë”.

Ashtu edhe ndodhi, në zgjedhjet e vitit 1926, megjithëse përfaqësuesit tanë nëpër Kosovë e Maqedoni fituan në zgjedhje, kjo e drejtë iu pamundësua, duke u thënë se ata nuk janë të dhëna të sakta, pastaj duke i përdorur bajonetat e xhandarmërisë me të vetmin qëllim që t'i rrënojnë ata, ndërsa njëri ndër ta ishte edhe Shaip Pirroku, kundër Halim Derallës.

Prandaj, dëshira ime ishte ta dëgjoj se çfarë do të thotë ai luftëtar i vjetër i kauzës kombëtare për situatën e atëhershme, aq më tepër se në atë takim propozimin tim për mbledhje i pari e pranoi.

Saktësisht në orën 13 ishin të gjithë në dhomë. Nexhmedin Besimi, me lejen e Baba Qazimit, filloi me teorinë e tij politiko-juridike, me dëshirën që në mënyrë sa më të qartë ta sqarojë situatën e atëhershme, në radhë të parë mua, por edhe të tjerëve, e veçmas Remzi Debreshit, si njeri analfabet dhe njëkohësisht ta arsyetojë linjën e tij politike dhe të shokëve të tij, njëlloj edhe të Kongresit të Prizrenit, në mënyrë që të marrë mbështetje nga pjesëmarrësit, ndërsa mua të më vendos në pozicionin që të mos mund t'i kundërvihem, madje edhe në formën më të butë, për çka u shpreh: "Besoj se e di gjendjen tonë të brendshme që përbën problemin më të rëndësishëm të kërret tanë, deri tash mirë e kanë zgjidhur dhe jam i bindur se do ta zgjidhin edhe më mirë, ndërsa këtë gjendje duhet ta dijë deri në detaje secili individ që të mund të vendos, për apo kundër nesh. Ndonjëri prej nesh mund të jetë në ndonjë rrugë tjetër. Nga ty nuk pritet pasiviteti e ndërsa unë nuk do t'i lejoja as vetvetes e as të tjerëve që këtë ta besojë. Të gjithë ne jemi nga ata që e duam atdheun tonë, prandaj konsideroj pa e zmadhuar se je i gatshëm të flijohesh për atdheun, dhe brohoriti "Për nënën Shqipëri, të vetmin shpërblim - bashkimi i kombit mbarë!"

Në atë moment nxori një flamur bukur të madh dhe me zë të lartë e lot në sy, brohoriti: "Do të të ruajmë ashtu siç të lanë Leka, Teuta, Pirro, Agroni dhe Skënderbeu, që pas shekujve të lëshosh hije valë-valë në vitin 1912 në kolonën tonë!"

Baba Qazimi urdhëroi që me zë të ulët të këndohet Himni i flamurit. Në mbarim e sipër tha: “Si sot më kujtohet fjala e Bajram Currit - Unë nuk dua marrëveshje, lirinë do ta fitoj me gjak, nuk ia kthej atdheut shpinën!”, duke shtuar se edhe ne padryshim se do t’ua japim meritat.

Për Nexhmedinin, kjo ishte një vërejtje, direktivë, nga ana e Baba Qazimit, që të kujtohet të shprehet se “do të luftojmë edhe kundër gjermanëve”.

Pas kësaj ndërhyrjeje, vazhdoi Nexhmedin Besimi: “Ja mua m’u dha rasti, nderi, që të flas mu në këto çaste, nuk dua dhe nuk mundem t’ua imponoj, sepse për këtë nuk kam të drejtë e as që jam i mendimit që përmes argumenteve të reja t’u ftoj të jeni në anën tonë, sepse mjaftojnë aq sa janë. Nuk ka asnjë ndryshim esencial të situatës në partinë tonë, Balli Kombëtar, si dhe në sjelljen e saj. Dua të them se Balli Kombëtar sot është partia më e fuqishme politike. Ajo mban administratën, ka ushtrinë e vet vullnetare, si dhe njësi të xhandarmërisë, shumicën e popullit me vete, gjithashtu edhe drejtuesit e saj ilegalë në mal me kuadrin dhe njësitë e nevojshme, por edhe organizatën e prapaskenës, aq të fuqishme saqë nuk mund të kalojë as gjë pa u vërejtur e as t’i kundërvihen. Marrëdhëniet e saj të shumta ndaj Muharremit (Bajraktarit – Q. L.), janë të atilla saqë Muharremi nuk konsiderohet pengesë as në vetë krahinën e Lumës, Ganiu (Kryeziu – Q. L.) vetëm se qëndron falë autoritetit të tij në rrethin e Gjakovës, zogistët janë shkrirë tek ne, Nacional-Çlirimtarja në fillim gëzonte një farë autoriteti, e tash vetëm po e humb dhe po përçahet, për shkak të mosmarrëveshjeve të brendshme, sepse kështu tash e dëshirojnë aleatët në mbarim të luftës.

Sa i përket situatës në Ballkan, për mendimin tim është e atillë saqë Partia komuniste në Serbi-Kroaci e Slloveni para luftës patën përfaqësues më të fuqishëm dhe kushte më të mira për t’u zhvilluar, mirëpo sërish nuk mund të bëjë asgjë, as në të arriturat materiale për klasën punëtore, përveç atyre të drejtave të punëtorëve, që janë pranuar në të gjitha shtetet moderne të botës edhe atë për shkak të ekonomisë së

dobët e të varur nga pushteti, as çfarë fuqie konkurruese nuk iu dhanë punëtorëve, as minimumin e të drejtave të tyre. Ja, nuk mund t'i fitojnë as ato të drejta sociale që të mund të shkojnë më tutje. Dua të them se nga fillimi i luftës, interesi i aleatëve imponon aleancë luftarake me rusët, pranimin e Luftës Nacionalçlirimtare vetëm për atë se Drazha Mihajloviq e refuzoi dëgjueshmërinë ndaj Londrës dhe Titos, me propozim të mbretit Pjetër mori gradën mareshal. Mirëpo, luftuan nën emrin e mësipërm të PK-së, duke pranuar nëpër shtabet e tyre jo komunistë, aq më tepër edhe përkrahësit e Drazhës, të cilët janë larguar nga Drazha Mihajloviqi pas marrëveshjes së tij me gjermanët, dhe iu bashkuan lëvizjes Nacionalçlirimtare.

“Në Shqipëri, situata nuk është e tillë. Nëse i përfshimë të gjitha luftimet e zhvilluara nga Balli Kombëtar, Nacionalçlirimtarja, Muharremit e Ganiut, do të shohim se ne (Balli Kombëtar – Q. L.) dhjetë herë më shumë e meritojmë, me atë që luftimet e para zhvilloheshin nën emrin e Nacionalçlirimtares, e jo të Partisë Komuniste. Dalja në sipërfaqe e tendencave komuniste, përjashtimi i disa personaliteteve nga pozitat udhëheqëse, madje edhe vrasjet, si shembull vuri në dukje disa sosh në Dibër /të cilat nuk më kujtohen/ dhe duke e humbur besimin tek populli, madje edhe të aleatët, kështu që janë dobësuar si të ne, ashtu edhe në Jugosllavi”.

“Jugosllavia ka plagë të tjera, pakica të shumta rreth kufirit të saj”, u shpreh në fillim Remzi Beu, për të shtuar: “Për rrethanat e atëhershme politike botërore ishte nevoja që Kroacia në ish-Jugosllavi të ishte në një pozitë të nënshtruar. Ndikimi nga jashtë ka qenë dhe është i fuqishëm. Nëse nuk kërkojnë shkëputje, do të kërkojnë federatë dhe në atë luftë të tyre serbët nuk do të jenë në gjendje që neve jo vetëm të na sulmojnë, por as të shikojnë nga lartë, deri në përfundim të luftës fitorja është në duart tona”.

Pas kësaj sërish mori fjalën Nexhmedini: “Bullgaria lufton në anën e gjermanëve dhe me ushtrinë e saj i ka tejkaluar kufijtë e saj dhe ka

shkuar në luftë frontale, prandaj për të nuk duhet të bisedohet. Rumania gjithashtu, vetëm Greqia është ajo e cila mund të pretendojë në territore tona, mirëpo nuk do ta lejojmë e as që do të pajtohen aleatët për pretendime të tilla, sepse tashmë tërë bota e ka të qartë se në Ballkan pas vdekjes së Perandorisë Osmane, padrejtësi të madhe i është bërë vetëm një kombi e ky është kombi ynë. Jam i sigurt se Patër Gjergj Fishta nuk do të ketë arsye që nga dheu të flet me atë hidhërim sikurse në vitin 1915, kur e pa Shqipërinë të shpërndarë nga aleatët: “Ah Evropë kurvë e vjetër pse e mohove besën e Zotit...”, sepse atdheu ynë do të jetë vetëm pa Çamërinë. U largova pak, sepse krejt këtë e bëj për çështje formaliteti për shkak të përsëritjes, si dhe ta njohim më mirë njëri-tjetrin”.

Më pas më pyeti mua: “A ke ditur për vrasjen në Dibër, përse e kanë vrarë?”

Iu përgjigja: “Kuptohet se nuk e kam ditur!”.

Pasi iu përgjigja, shtoi: “E vranë për shkak të asaj se ka thënë se luftën e fundit do ta kemi me titistët, për shkak të Kosovës dhe Maqedonisë, dhe shembuj të tjerë me radhë që vënë në pah përçarje në radhët e tyre”.

Baba Qazimi dhe Kadri Saliu shtuan “se te ato (Partia komuniste e Shqipërisë-Q.L.) janë të përditshme dhe të shumta këto ndodhi që nuk kemi kohë t’i numërojmë. Një gjë është e saktë se nuk duhet minimi ynë”.

Nexhmedini: “Më vjen mirë që ju të dy (Kadri Saliu dhe Remzi Beu-Q.L.) dhe Remzi Debreshi jeni këtu që të na dëgjoni neve dhe shpreh habinë time, përse nuk i takoni Ballit Kombëtar. Ndërsa Remzi Debreshi nuk ishte as prezent në Kongresin e Lidhjes II të Prizrenit”.

Remziu (Beu-Q.L.): “Është e vërtetë që nuk mora pjesë, këtë e di Kadriu. Më vjen mirë që e dëgjova fjalimin tuaj, për çka unë i jam bashkangjitur. Me një kujdes të veçantë e dëgjova elaborimin tuaj, si për çështje ndërkombëtare po ashtu edhe për situatën e brendshme të Shqipërisë,

shteteve ballkanike dhe tek ne. Lidhur me fuqitë proporcionale të PK-së, sipas teje, ne jemi para faktit të kryer, prandaj na vjen mirë të gjithë se atdheu ynë së shpejti do të jetë i lirë pa Çamërinë”.

Unë (Gajur Deralla-Q.L.) jam oficer dhe i penguar nga ligjet e vendit, nuk i kam takuar asnjë partie politike. Kjo nuk nënkupton se oficerët nuk i vlerësojnë situatat, përkatësisht se nuk mund t’i vlerësojnë përpjekjet apo të mirat e të këqijat e ngjarjeve për të ardhmen e atdheut. Mirëpo, efektivisht nuk jam pjesëtar partiak si të tjerët që ndoshta ju, por edhe unë, i njoh se janë zogistë apo ballistë, ose simpatizues të LNÇ-së. Deri tash vetëm kam dëgjuar për Ballin Kombëtar. Nuk di asgjë për qëllimet e saj si parti, e cila pretendon se do ta marrë aparatën shtetëror në duart e veta, duhet të më informoni? E di vetëm atë se Balli Kombëtar kërkon kufijtë etnikë. E di edhe atë se në ballë të tij qëndrojnë dy figura, të cilët nuk kanë as çfarë pasurie përveç një këmishe. Ata janë, Mitati dhe Mediu. Gjithashtu mund të them edhe për Fuad Dibrën, aq më tepër se e ka shkrirë pasurinë e tij për atdheun. Me ta mund të krahasohet edhe Lef Nosi, mirëpo nuk do të thotë se ata njerëz sot shkojnë në rrugën që duhet shkuar. Më thoni se çfarë mendoni, duhet apo nuk duhet të luftojmë. Çfarë duhet dhënë për rregullimin shoqëror, si mendojnë të zgjidhet çështja e industrisë, lidhur me këtë edhe çështja e punëtorëve?”.

Krejt këtë do ta kuptosh së shpejti në Tiranë, ndërhyri Baba Qazimi. Pas kësaj ndërhyrjeje, unë vazhdova duke e ruajtur të drejtën që së pari të njoftohem dhe të bindem e më pas të pranoj obligimin partiak (ishte dëshira ime më e madhe ta dëgjoj këtë): “Pas pranimit të obligimit mund t’ju them se nuk do të lidhem me asnjë dëshirë individuale”.

“Ashtu është!”, pohoi Remzi Beu – duke shtuar: “Dëshira individuale është veti e rrezikshme, aq më tepër nëse njeriu gjendet në pozitë më të lartë”.

“Tash (vazhdon fjalimin Gajur Deralla-Q.L.) mund t’ju them diç për mëmëdheun tonë të nënshtruar dhe oficerët e saj. Ushtari ynë që nga

dita e parë e ardhjes së Italisë e ka parë se ne jemi të nënshtruar, më mirë thënë- kukulla, duke mos pasur besim tek ne. Më shumë se gjysma u arratisën në LNC, shtabi i së cilës gjendej në afërsi prej 10 km., (me siguri bëhet fjalë për luftën italiane-greke në vitin 1941, ku autoritetet e atëhershme fashiste italiane mobilizuan me forcë mijëra shqiptarë, ku pjesa dërmuese e tyre dezertuan, në mesin e tyre edhe Gajur Beu-Q.L.), vend është i rrethakuar nga të katër anët me fuqi pushtuese italiane dhe në përbërjen e tyre edhe Batalioni "Deja", ushtarët e të cilit as që u interesonte të ngelin aty. Lirisht mund të them se neve na detyronin t'u dërgojmë armatim, veshmbathje, për çka u detyruam të arratisemi. Unë mund të flas për vetveten, duke mos përjashtuar mundësinë që dikush t'u takonte atyre, i cili si prapaskenë ka qenë te ne, mendoj për oficerët e nënoficerët. Raste të tilla janë të shumta, ndaj po ju pyes juve: Mitati, a është në ilegalitet? A ka njësi të veta? Së paku një njësi apo shtab, sepse Nexhmedini, në elaborimin e tij, duke folur për luftën e popullit tonë, u shpreh: "Përveç Muharrem Bajraktarit, Bajo Samia dhe N. Xh., me siguri edhe Balli Kombëtar ka luftuar dhe, marrë në përgjithësi, luftimet e shqiptarëve janë 10 herë më shumë sesa ato jugosllave. Për LNC-në, e di secili, Muharremi i ndali italianët dhe i çarmatosi; Bari Samiu një herë te Ura e Zezë i ka sulmuar gjermanët, vetëm njëherë, mirëpo i ka sulmuar, edhe Balli Kombëtar ka kaluar në luftë të hapur".

Remzi Beu: "E gjithë kjo është e vërtetë, mirëpo unë ta jap fjalën e nderit se gjithçkaje do t'i vijë fundi, se ne me të mirë apo me forcë do të përplasemi me gjermanët, mendoj pa dëshirën e ndonjë udhëheqësi, mosmarrëveshja është vetëm koha".

Pas mbarimit, Baba Qazimi e pyet Nexhmedinin e ri - gostivarasin: "A i ke shënuar të gjitha?". Unë (Gajur Deralla-Q.L.), si gjithmonë nënvizoj gjithçka. "Gjithçka (i përgjigjet Nexhmedini i ri Baba Qazimit-Q.L.) çfarë keni folur, dhe procesverbali është nënshkruar nga të gjithë ne. Unë në procesverbalin e mësipërm u nënshkrova si njeri jashtë partisë dhe i njëjti ngeli te Nexhmedin Besimi. Me urdhër të Baba

Qazimit dhe me nënshkrimin e tij u kopjua një ekzemplar dhe u verifikua, që të nesërmen u dorëzua deri te Kongresi i Lidhjes II të Prizrenit”.

Pas përfundimit, Nexhmedin Besimi sërish filloi: “Kundërshtari i vetëm dhe më serioz i partisë sonë është LNÇ-ja, mirëpo përsëris se duke pasur parasysh tërë territorin tonë që e administrojmë, numrin e të papunëve në proporcion me numrin e popullsisë sonë, del që nuk ekziston klasë punëtore. Ja përse: fabrikat janë të pakta, numri i vogël i minierave 4-5, ndërsa të tjerat përbëjnë vetëm punëtoritë, edhe atë shumë larg njëra prej tjetrës. Mund t’i shtojmë edhe punëtorët që punojnë nëpër dyqane, që me këtë nuk mund të plotësohet ai numër që mund të çojë për të menduar”.

“Pak më parë fola për oficerët (sërish merr fjalën Gajur Deralla – Q.L.), për atë ushtrinë tonë të vogël, mirëpo më ndërpretë. Oficerët pa mëshirë merrnin material të ndryshëm ushtarak dhe armatim, dhe nën urdhrin e drejtuesve të tyre më të lartë i dërgonin nëpër shtëpi. Më vonë u kuptua, se ua kanë shitur civilëve, edhe atë jo një, por më shumë prej tyre, ndërsa njëri nga ata, kapiten Shaban Mustafai, këtë e bënte në mënyrë të hapur. Ai është zogist, ka edhe ballistë, ndërsa pjesëtarët e prapaskenës janë përkrahësit e LNÇ-së”.

Me këtë përfunduan bisedimet. Të nesërmen në ora tetë do të shkonim te komanda e divizionit, ku qemë ftuar për shkak të emërimit tim për komandant të Batalionit në Tetovë. Kjo ishte ide e Komitetit, i cili si edhe në vendet e tjera të Shqipërisë kishte kërkuar njeriun e tyre. Propozimin që unë të emërohem komandant i Batalionit, tashmë e kishte miratuar Mehdi Frashëri. Duhej njoftuar edhe Komanda e divizionit të porsaformuar në krye me nënkolonelin Qazim Komanin. Nexhmedini përgatiti raportin, duke e njoftuar divizionin se nesër para nisjes për në Tetovë të mbanim mbledhje me ta, me qëllim që të mund sadopak të më dëgjonin mua lidhur me themelimin e Batalionit. Pas gjysmë ore, megjithëse ishte pas mesnate, erdhi oficeri-korrier, kapiten i artilerisë K.

Abdyrrahmani, i cili na njoftoi se saktësisht në orën 8, brenda mundësive edhe në 7, do të pranoheshim. Ne u dakorduam që të jetë në orën 7.

Të nesërmen, në orën 7, kësaj radhe së bashku edhe me vëllanë tim, Hysen Deralla, ishim në komandën e divizionit. Na pranoi nënkoloneli, Qazim Komoni, dhe shumë oficerë të komandës së divizionit, në dhomën e madhe të përgatitur paraprakisht, ku pas meje qëndronte kapiteni Abdyrrahman Guri. Përveç anëtarëve të komitetit nga Tetova, Gostivari, Kërçova e Struga ishin edhe anëtarët e komitetit vendor të Lidhjes II të Prizrenit për Rekën, emrat e të cilëve nuk më kujtohen. Komitetin e Prizrenit e përfaqësonte Sulejman Ashiku, me një të ri, i cili si duket ishte sekretar. Përveç tyre, prezent ishte Asllan Boletini, ish-prefekti i Pejës dhe Bedri Pejani, gjithashtu nga Peja.

Me insistimin e nënkolonel Komonit, bisedën e filloi Baba Qazimi, i cili u shpreh: “Si kudo, edhe ne dëshirojmë të krijojmë ushtrinë tonë në Tetovë, e më vonë në Gostivar, Kërçovë, Strugë, për çka nga Mehdi Frashëri kemi kërkuar që për themelimin e saj të vijë kapiten Gajur Deralla, si njohës i atyre krahinave. Jam i informuar nga të dyja anët, mendoj nga ju dhe komandanti në Tiranë, dhe kam dhënë vlerësim pozitiv, mirëpo për çdo vend duhet edhe pëlqimi i tij”, tha në fillim Baba Qazimi, për të shtuar: “Në këtë qëndron dëshira jonë, përveç asaj që e kemi thënë në vetë aktin dhe aq më tepër që Gajuri deklaroi se nuk i takon asnjë partie. Prandaj dëshirojmë që së bashku të shqyrtojmë, aq sa është e mundur dhe, mendoj, se fillimi u takon juve, z. kapiten”.

Baba Qazimi e bëri këtë për të parë se a thua do ta përsëris krejt atë që e thashë më herët. Kuptohet, pasi deponova nënshkrimin me protokoll, thashë: “Unë, fjalët e mia e të tuaja i nënshkrova me protokoll dhe me siguri se nga Kongresi ka ardhur deri te komanda e divizionit”.

Nënkoloneli: “Po, para 30 minutash ka ardhur dhe krejt ajo është e saktë, mirëpo do të mënjanohet. Çdo fillim është i rëndë. Në ndërkohë mund të jetë edhe më rëndë. Mosmarrëveshja nuk është në ato përmasa sa ti,

përkatësisht unë i mendojmë. Për shpëtimin, në radhë të parë, nuk bëhet fjalë për LNÇ-në, por për Muharremin dhe Ganiun. Nuk mendon vetëm ti ashtu, por të gjithë ne" /në atë çast hyri brenda ish-majori i shtabit të përgjithshëm të Zogut, komandanti i shkollës së oficerëve rezervë, Suki Shkupi, u ul në heshtje në një karrige të zbrazët/.

Majori Salim Hamza, komandanti i qarkkomandës së xhandarmërisë së Drinit: "Do të vijë edhe deri te ajo, mirëpo duhet të jemi të durueshëm. Nuk kemi ne një popull 100 milionësh, e as që jemi 14 apo 18 milionësh. Ajo që është bërë deri më tash në dëmin tonë duhet të mbyllet, ndërsa ajo çka do të bëhet do të jetë në dobinë tonë. Për këtë të jesh i bindur dhe së shpejti do të ndodhë, përndryshe kur të niseni për në Tiranë, kushdo që të vijë me ju, mendoj se kjo çështje është me interes vital, duhet të jeni më shumë për ta dëgjuar Mehdiun".

Baba Qazimi, Kadri Saliu, Remzi Beu, secili në mënyrën e vet, deklaruan se: "Përveç delegatëve të komiteteve vendore, do të jetë edhe Abdyl Dura nga Kaçaniku, nga 4-6 sish prej secilit qark dhe udhëheqësit e fuqive të armatosura vullnetare". Koloneli i përsëriti emrat nga akti i dërguar: "Xhemë Gostivari, Mefail Zajazi, Bedri Samiu, me nga katër ndihmësit e tyre, të cilët morën pëlqimin sipas fjalëve të Suki Shkupit. Duhet që heronjtë tanë personalisht ta dëgjojnë shkëlqesinë e tij, Mehdi Frashërin".

Kolonel Komoni: "Dua ta di se kur do të niseni për në Tiranë?".

"Do ju lajmërojmë!", u shpreh Baba Qazimi, për të shtuar: "Komitetet duhet të mbajnë mbledhje në vendet e tyre që të mund ta rregullojnë gjendjen në bazë, sipas asaj që është vendosur në Kongresin e Dytë. Me ta sërish do të takohemi në Tetovë, për një mbledhje të dytë të përbashkët, dhe për atë do t'ju njoftojnë juve". Kolonel Komoni: "Përderisa Remzi Beu arrin në Strugë, ju mund të mbani mbledhje në Tetovë e Gostivar, shkoni me kohë dhe ma dërgoni Xhemën që të shihem unë me të, më ka premtuar".

“Tash (vazhdon fjalimin e tij kolonel Komoni –Q. L.), ta dëgjojmë Gajurin se si ai e paramendon themelimin e batalionit”.

“Unë (Gajur Deralla–Q.L.), për shkak të pozitës që kanë, Tetovën e Gostivarin – konsideroj si sektor të parë, Kërçovën - sektor i dytë, ndërsa Strugën - sektor i tretë. Jam i mendimit që njësitë tona duhet të jenë të pajisura me armatim të lehtë. Numri më i madh, me armë automatike edhe atë: batalionet në Tetovë e Gostivar të jenë për 1/3 më të dobëta nga ato që duhet të themelohen në Kërçovë e Strugë. Për këtë arsye, neve na nevojitet transporti rrugor, qerre, kuaj në përmasa të mjaftueshme. Duhet të aftësohen për luftë të izoluar dhe për një periudhë më të gjatë, ndërsa për çdo eventualitet edhe një sasi të caktuar të automobilave, nëse i kemi. Fuqinë e batalionit do ta përcaktojë komanda në Tiranë”.

“Për shkak të autonomisë e pavarësisë së çetave, edhe armatimi i rëndë duhet t’u jepet çetave. Mirëpo, për shkak se terreni është tepër kodrinormalor, duhet më shumë t’i mbajmë në batalion, si njësi e veçantë. Këtu i përfshij edhe minahedhësit dhe, në atë territor, në rrethana të ndryshme, më të rënda që mund të paramendojmë, qoftë klimatike apo luftarake, duhet patjetër t’i kushtojmë vëmendje lidhjes me batalionin dhe lidhjeve reciproke të batalioneve që nuk mund të mbahet përmes telefonit, që lehtë mund të shpëputen nga individë të ndryshëm, pa i kapur askush”.

Komoni: “Kjo është e saktë!”.

Unë (Deralla –Q.L.): “Në momentin e nevojshëm, dhjetë minuta vërtet janë shumë, prandaj secila çetë të posedojë radio-aparat”.

Komoni: “I kemi dhe janë të mira, bëjmë përgatitjen e kodifikimit të çelësave, sa i përket lidhjes me Tiranën dhe me ju, do të jetë me radio-aparate që i kemi”.

“Batalioni (vazhdon fjalimin Deralla - Q. L.), përveç 4 çetave këmbësorie mund të ketë edhe çetën e komandës, që do ta përbënin personeli mjekësor, me mjekë, oficerë specialistë për radio-telefoni etj.,

numrin e nevojshëm të kuajve për transportim nëpër thellësi dhe gjerësi, përveç çetës transportuese. Me këtë do të sigurohet plotësimi i çetës transportuese me municion, derisa zgjat luftimi dhe në raste të tjera. Dua të them, të mbështetet më shumë në transportin me kuaj, si Struga, po ashtu edhe Kërçova. Madje, në përmasa të njëjta mund të sulmohen edhe Gostivari e Tetova, nga anë të ndryshme. Në këtë mënyrë do të jemi të detyruar të pranojmë luftën larg rrugës. Kjo me siguri do të ndodhë, prandaj nevoja e parë do të ishte transporti, mendoj të sigurohet me kuaj që kanë ngelur nga italianët e jo të merren nga popullsia, ose të pritët nga blerja. Për të njëjtën, nuk guxohet të pritët ushtria pa transport, sepse lëvizja do të jetë e dobët dhe në këtë e kemi, mirëpo jo këtu, por në Tiranë. Përveç kësaj, në përbërje të çetave do jetë edhe njësitë komandues me adjutantit”.

Ndërhyri koloneli: “Ajo çka dihet, sa i përket automobilave, do t’i jepej batalionit në Gostivar dhe një numër të caktuar edhe në Kërçovë”.

Deralla: “Batalionet, veçmas në Kërçovë e Strugë, numerikisht duhet të jenë më të fuqishëm, sepse mendoj se do të ketë më shumë luftime. Për ta mbajtur në duart tona rrugën Tetovë-Kërçovë, pa asnjë kusht, duhet themeluar dy njësi të përhershme lëvizëse dhe ato t’i mbajë Koloneli. Nuk do të ishte keq të kemi edhe një njësi lëvizëse në drejtimin Kërçovë-Dibër, e cila do të varej nga batalioni i Kërçovës dhe një në drejtimin Gostivar-Dibër, e cila do të varej nga batalioni i Gostivarit. Në realitet, të gjitha njësitë nuk do të kishin seli të përhershme në asnjë vend, ndërsa të lidhen përmes radios”.

“Edhe kjo mundet!”, tha koloneli.

Deralla: “Ndoshta nuk do ketë aspak nevojë!”

Koloneli: “A nuk parasheh ndonjë kërcënim apo sulm prapa shpine?”

Remzi Beu: “Gjithsesi se po, nëse në këto nuk i parashohim, do të kërcënohem”.

Unë (Gajur Deralla-Q.L.): “Në batalion nuk kam paraparë asgjë për mbrojtjen ajrore, për faktin se nuk e di se a është konfiskuar nga italianët. Në dorën tonë duhet të kemi së paku 6 copë nga më të lehtat”.

Koloneli: “I kemi këtu, do t’ju jap jo 6, por 26, kështu që secili batalion të ketë çetën e vet të mitralozave anti-aeroplan”.

Deralla: “Transporti me kuaj së paku duhet të ketë tre bateri në segmentin Tetovë-Strugë, edhe atë 2 në Kërçovë dhe 1 në Strugë. Ja përse, në Gostivar e Tetovë kemi më shumë njerëz, ndërsa në Kërçovë e Strugë më pak, dhe unë thujse pajtohem në tërësi, mirëpo do ta shohim”.

“Atje do të vijë si Komoni, po ashtu edhe kapiteni i artilerisë, Fezim Cerusi dhe Haxhi Stasa”, tha koloneli.

Koloneli më pyeti: “Si mendon për ilaçet dhe çështjet e tjera?”

Unë (Deralla-Q.L.) iu përgjigja: “Doktor e kemi Xhafer Sulejmanin dhe dhëndrin e tij Dr. Zyrapin. Sanitar, mendoj se janë tetë. Për momentin, në spital kemi 23 apo 25 krevate. Mirëpo, me marrjen e shtëpisë sime, në fillim mund të kemi 100 krevate dhe 1500 copë ilaçe. Këta mund ta dinë, sepse atje kemi gjithnjë të sëmurë”.

Nexhmedini: “Do të gjendemi, do t’i marrim nga komanda!”.

Nuredini: “Po, do të gjendemi!”.

Koloneli: “Unë u njoftova shumë sa i përket formacionit dhe sistemimit – krahas sugjerimeve tona, do të varet edhe nga komanda. Mirëpo, para Mehdiut duhet të bëni elaborimin edhe më të thelluar dhe të insistoni që në konferencë të marrin pjesë gjeneralët Prenk Previzi dhe Aqif Përmeti, dhe të tjerët nga Shtabi i Përgjithshëm. Ata e dinë se çfarë ka këtu dhe juve do t’ua japin planin dhe urdhrin. Lidhja me mua duhet të jetë e siguruar ditë e natë. Posa të themelosh batalionin e parë, do të vijë komandanti i Divizionit”.

Remzi Debreshi, pyeti: "Përveç kësaj, mendoni të formoni edhe njësi të tjera vullnetare e polici në komunat urbane dhe rurale, që t'i keni si fuqi të armatosura?".

Komandanti: "Shumë mirë, edhe kjo do të bëhet, kuptohet se përmes hartimit të një plani!"

Komandanti: "Sa i përket marrëdhënieve organizative, e lexova raportin tuaj të protokolluar, dëshiroj ta pyes Remzi Beun, nëse pajtoheni edhe ju, me Gajurin dhe me Nexhmedinin, sa i përket PK të Shqipërisë dhe lidhjet e saj? Unë më shumë dakordohem me Gajurin, mendoj se Partia Komuniste është e vetmja fuqi deri në mbarimin e luftës. Ata me vete kanë shumë njerëz nga Shqipëria, ka shumë punëtorë. Atyre u janë bashkuar edhe fshatarësia, disa për shkak të bindjes, janë simpatizues apo anëtarë partie, disa të tjerë oportunistë, të tjerët vijnë nga bota e huaj, të cilët mendojnë se vetëm në atë mënyrë mund të arrihet deri te vendlindja. Komunistët asnjëherë dhe askund nuk pushojnë!"

Baba Qazimi: "Edhe në gjumë nuk pushojnë!"

Komandanti: "Komunistët premtojnë gjithçka, me çka i mashtrojnë masat e shqetësuara nga italianët, e të tillë janë të shumtë. Ky është mendimi im, në komandën ushtarake dhe në udhëheqjen politike të LNÇ-së, tashmë vërehen përçarje të dukshme. Të jesh në komandën e Mareshalit Tito ose ta refuzosh, disa kanë nënshkruar marrëveshje me Titon në Bosnjë, mirëpo ende dyshoj se kanë shkuar aq larg sa i përket tradhtisë, ku edhe Kosovën dhe Maqedoninë ua kanë dorëzuar Titos në disponim. Njëkohësisht, mendoj se mund ta bëjnë, sepse deklarojnë se nuk i pranojnë kufijtë e fashizmit. Ne vetë do t'i kthejmë, nëse do të vijë deri te ajo që ata vetë t'i kthejnë. Thellë do të mashtrohen. Mendoj se nuk do ndodhë kjo, sepse ne do të përgatitemi seriozisht, që ta bëjmë atë që ata e dëshirojnë, gjendjen e tanishme të aleanca anglo-amerikane. Me përpjekje të fuqishme nga ana jonë, jam i sigurt se situata do të rikthehet në anën tonë. Në rast se deri në fund do të jemi aktivë, e fundi mund të

vijë edhe nesër, sepse ngjarjet po zhvillohen me shpejtësi të furishme. Ndoshta lufta mund të zgjasë edhe një vit e më shumë, e nëse ngelim pasivë, nuk kemi me çka të krenohemi, u ngelë atyre. Prandaj, sa kalon koha ne mund të humbim”.

Mentor Qoku /tash m’u kujtua emri i struganit të dytë, Mentor Qoku, djali i Hamdi Ohrit/, i cili vazhdimisht heshtte, duke iu kundërvu me nervozë Nexhmedinit, tha: “LNÇ-ja nuk i lejon qetësi armikut, ajo me luftën e saj nuk duhet nënçmuar. Lufta detyrimisht duhet të fillojë. Pa të nuk ka respekt!”.

Koloneli: “Unë që para tre vjetëve, përderisa isha në shtëpi, i kam thënë Mitatit për luftë të pa kompromis, që të shihet se kush ku gjendet. Përndryshe nuk do të jetë mirë. Njëllon kam deklaruar edhe në prag të rënies së fashizmit, edhe tash jam përkrahës i asaj, vetëm se pres urdhëresën dhe ta përmirësojmë atë që e tha kapiten Gajuri për ushtrinë e Prishtinës, kuptohet në bashkëpunim me komitetet. Sa i përket luftës, më është thënë se janë të sigurt se duhet pritur një apo më shumë muaj, prandaj mund të pritet për një apo dy muaj, ndërsa konflikti detyrimisht do të fillojë. Pas jush, unë do të shkoj në Tiranë” /në atë moment hyri brenda një oficer i shtabit dhe dorëzoi një copë letër/.

Koloneli, duke e lexuar e pa oficerin dhe tha: “A është ai këtu?”

“Këtu është!”, iu përgjigj oficeri.

“Le të hyjë!”, shtoi koloneli.

Hyri brenda Bislim Bajgora, të cilin e njihja mirë, njeri kolosal, ushtar imi në divizionin 17 të këmbësisë të vojvodës Mishiç në Vinkovc. Shërbeu në vitin 1930, në batalionin e parë, çeta e tretë. Kuptohet se e panë me kureshtje.

Major Hamzë Drini e pyeti: “Gjermanët i kanë pushtuar të gjitha magazinat?”

Duke mos thënë asgjë, oficeri u drejtohet Pajazit Boletinit dhe Asllanit: “U është lëshuar urdhri që ashtu të veprojnë, që të mos kundërshtojnë dhe ta përsërisin atë të Prishtinës”.

Pas një heshtjeje të vogël, kolonel Pajaziti tha: “Këtë do ta shohim, sepse gjermanët dyshojnë se mos është diçka tjetër”.

Asllani përsëriti: “Sido që të jetë, më vështirë se për momentin nuk mund të jetë, sepse deri tash asgjë nuk përfaqësojmë. Ashtu siç deklaroi kapiteni, nëse nuk shkohet kah e mira, le të shohë secili rrugën e vet”.

Ja, hyri brenda nënkoloneli gjerman, me një kapiten që njihte italishten.

Koloneli nuk u ngrit nga vendi, pasi i zunë vendet, Qazimi tha: “I grumbullova për t’u dhënë urdhrin se cili tash do t’u sulmojë, urdhëroni mbrohuni tash, kur dini të pushtoni magazina. Ushtarët e mi në çdo hap do ju vrasin. Juve nuk mund t’ju kemi miq, ndaj dhe dilni jashtë!”.

Gjermani, duke e kthyer shpinën doli. Para tij vrapoi Bislim Bajgora që ta lajmërojë Pajazit Boletinin, i cili shpejt erdhi, duke thënë se nuk i vjen keq, sepse e kanë merituar, për sjelljet ushtarake të një nëntogeri, do ta dënojnë. Më pas të gjithë dolëm.

Të nesërmen në mbrëmje arritëm në Tetovë. Të pasnesërmen, me angazhimin e Shaip Kamberit, u mbledh Komiteti i Tetovës jo me të gjithë anëtarët, sepse disa prej tyre ishin larg në fshatrat e malësisë së Sharrit. Në atë mbledhje të parë foli Shaip Pirroku, si kryetar i Komitetit Komunal – Komuna e Pirroikut, qarku i Tetovës. Ai nuk pajtohej me Shaip Kamberin që atë ditë të debatohet dhe tha: “Unë nuk mund të nënshkruaj as çfarë protokolli, përderisa nuk janë prezent anëtarët e tjerë, sepse kjo është një ngjarje shumë me rëndësi dhe të mos pyeten për marrjen e vendimit. Prandaj dua thirrje të përgjithshme për të gjithë anëtarët e komiteteve rurale e urbane, nëse ka mundësi deri te

personalitetet me ndikim si nëpër qytete, po ashtu edhe nëpër fshatra. Dua ta dëgjoj se sa vende mund të siguroni”.

Shaip Kamberi menjëherë tha: “76 vende, 45 anëtarë të të gjitha komiteteve, të tjerët udhëheqës të vullnetarëve dhe personalitete të shquara”.

Kështu secilës komunë i ra të sjellë edhe nga dy. Të pasnesërmen, dita e shtunë, morën pjesë të gjithë dhe unë me komandantin e çetës, Hilmi Miletini, si dhe oficerin e intendencës, Ali Rahimin /tash që të dy të vrarë/.

Pasi sekretari i Komitetit të Tetovës, Nexhmedin Besimi kërkoi leje nga Shaip Kamberi, e hapi debatin, duke lexuar vetëm në pika vendimin që u soll në Kongresin e Lidhjes II të Prizrenit. Më pas lexoi rezolutën e mbledhjes sonë në komandën e divizionit. I luti anëtarët të mendohen mirë dhe të japin pëlqimin e tyre, duke thënë: “Sot apo kurrë duhet ndihmuar themelimin e ushtrisë, duke mos kursyer asgjë!”.

Ai, duke mos folur asgjë lidhur me gjermanët dhe Ballin Kombëtar, Zogistët dhe LNÇ-në, vetëm se tha: “Vëllezër të dashur, djemtë e juaj vërtet do të luftojnë për të ardhmen e atdheut tonë, për shpëtimin e të gjithëve. Në krye të shtetit është Mehdi Frashëri, i cili përbën simbolin e rezistencës, flijimit dhe heroizmit të kombit tonë. Nëse marrim pëlqimin tuaj, ne do të tubohemi edhe një herë në numër më të vogël, siç kam deklaruar me anëtarët e Gostivarit, Strugës, Kërçovës, Rekës, si dhe Dërvenit, Kaçanikut, aq sa munden ta kalojnë kufirin, që të ndajmë mendimet edhe me ta dhe nga këtu do të udhëtojmë për në Tiranë te Mehdiu, që të gjithë, përkatësisht më shumë se sa jemi këtu prezent, ta dëgjojmë zërin e tyre. Mendoj se askush nuk do ta kundërshtojë. Edhe njëherë po e përsëris, ushtria jonë nuk do t’i tejkalojë kufijtë e shtetit tonë, do të jetë në duart e oficerëve tanë e jo të të huajve, do të kemi me shumicë nga qyteti ynë dhe nga fshatrat oficerë profesionistë apo me

grada të larta, si në trupat aktive po ashtu edhe te fuqitë vullnetare, ndaj lus të shpreh secili mendimin e vet”.

Ibrahim Pirroku: “Sa i përket ndihmës, ne jemi këtu dhe nuk e kursejmë veten, mirëpo do të doja një gjë ta di, se si do t’i njohim dhe propozojmë oficerët tanë? Ata që vijnë nga Tirana, kush do t’u besojë? Ata këtu, vëlla apo vëllezër, nga ana tjetër, Hysni Dema - zogist, Hamdi Dema - me komunistët jugosllavë në mal, Ukë Cami major, Ahmet Cami /i vrarë nga italianët/ së bashku me vëllanë më të ri si partizan, Qazim Lusha këtu, Dervish Lusha me anglezët, i cili nga këtu mori tërë armatimin, madje edhe drutë. Në cilën anë duhet luftuar, ne këtë nuk e dimë. Sërish mendoj se jemi në anën e shtetit, mirëpo të ruhem nga ardhja e këtij!”

Pasi e dija me siguri se nuk ma do të mirën, sepse e dinte se e njoh si kundërshtar i Xhemijetit, iu përgjigja: “Unë nuk jam adhures i deputetit Marko Petroviq, para luftës, a e dinë këtë?”. Ai me hidhërim e lëshoi sallën, duke thënë “se do ta ndihmojë ushtrinë me gjithçka dhe vetë ai do të jetë ushtar, vetëm se nuk pranon që ta komandojë Deralla!”

Shaip Kamberi, si udhëheqës i Komitetit të Tetovës, premtoi se do t’i japë më të aftit dhe më të sprovuarit, me lutje se që nga fillimi nuk do të shërbejnë në vendlindjen e tyre, edhe atë shumica e oficerëve, sepse konsiderohet se është një veprim i dëmshëm, por në Tetovë, Gostivar, Strugë e Kërçovë, përveç atyre, shërbimi i të cilëve është nevojë e domosdoshme që të jetë në vendin e tyre. U pajtuan, më pas morëm lidhje me Gostivarin, nga ku Kadriu Saliu lajmëroi, se sërish nesër do të vijë me anëtarët e tjerë, për shkak se anëtarët e Strugës, Rekës e të Kërçovës, të cilët duhej të arrinin në Gostivar, nuk kishin arritur. Të nesërmen lajmëroi sërish se pëlqimi është i madh dhe mund të gëzohemi. Ne u shpërndamë, për t’u tubuar të nesërmen.

Prezent nga Struga ishin: Remzi Beu, Mentor Qoku dhe një nga fshati, emri i të cilit nuk më kujtohet, si dhe katër udhëheqës të fuqive vullnetare. Nga Kërçova: Shaban Efendiu, Mefail Zajazi dhe një

vullnetar nga Zajazi. Gostivar: Kadri Saliu, i riu Nexhmedini, Xhemë Gostivari, Llok Llakavica dhe një vullnetar tjetër, si dhe katër pari të Gostivarit, emrat e të cilëve i kam harruar dhe Remzi Debreshi me 6 pari të tjerë nga fshatrat. Tetovë: I tërë Komiteti i qytetit, Shaip Pirroku, Ali dhe Iliaz Bogovina, Kasum Porroi dhe katër të tjerë, përveç Arif Dragomancit, Memish Bukoviqit dhe Tahir Ivanja (tre të fundit përfaqësonin Dërvenin, Shkupin dhe Kaçanikun që ishin nën pushtimin bullgar -Q. L.).

Pëlqimi për ndihmë qe 100 për qind, madje do të siguroheshin edhe rrogat për oficerët, ku veç të tjerash u tha: “Mua më lutën të kërkoj sa më shumë nga oficerët dhe nënoficerët e njohur, të cilët do të gradoheshin në grada oficerësh nëse këtë komanda do ta pranonte”.

Një propozim i tillë ishte nga Remzi Beu. Më pyetën mua, Nexhmedini i ri dhe Mentor Qoku, se si mendoj t'i përgatis vullnetarët, të cilëve iu përgjigja: “Mua nuk më takon ta komentoj këtë para prezencës së pjesëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm. Ja ku e kemi Ali Shefqet Shkupin, i cili dëshiron të formojë për ta magazina të veçanta për ushqim, veshmbathje dhe municion nëpër qytete, do të vijë me ne në Tiranë. Ne të njëjtën ditë u nisëm me tren për në Strugë, ku atje na pritnin me kamionë për të udhëtuar për në Tiranë. Pas tre ditëve u pranuan të gjithë pa përjashtim nga Mehdi Frashëri, në ndërtesën te “Rruga e Elbasanit”, ku dikur jetonte e ëma e mbretit Zog”.

Përveç neve, prezent ishin: Asllan Boletini, kapiten Abdyrrahman Guri, i deleguari si përfaqësues i komandës së divizionit në Prizren, Pajazit Boletini. Nga ministrat Rifat Begolli, Xhafer Deva, Bedri Pejani, Rexhep Mitrovica, gjeneral Prenk Previzi, gjeneral Aqif Përmeti, nënkolonel Samiu, si dhe prefektët e Tetovës dhe të Dibrës, Tafil Boletini dhe Munir Tërshana, si dhe doktori i shkencës së drejtësisë, Rexhep Xhela.

Salla ishte e stërbushur, Mehdiu filloi: “Unë jam mirë i informuar për gabimet e individëve dhe komandat e komiteteve vendore. Gjithsesi se ato janë lëshime të natyrshme, ne ato do t'i mënjanojmë, midis nesh nuk ka as çfarë mosmarrëveshjeje. Në taborin e kundërt do të ketë gjithnjë e më shumë. Lufta jonë do të jetë efikase dhe do ta fillojmë së shpejti. Ne për këtë fuqishëm jemi të vendosur. Gjithçka çka jepni është për ju, përkatësisht për të mirën tonë të përgjithshme. Kapiten Deralla ta fillojë punën, si edhe kolonel Ali Shefqet Shkupi me vullnetarët, sipas planit që e kam dhënë. Nuk është qëllimi të bëjmë diçka, duke mos i llogaritur pasojat. Ne të gjithëve do u tregojmë se jemi të zotët e këtij vendi. Këtë shumë mirë e dinë edhe perëndimorët dhe ata të parët do na e pranojnë mundin. Formacioni i ri ushtarak, me fillimin e aktivitetit të kapiten Derallës dhe kolonel Shkupit, në fillim nuk do të ketë asnjë oficer apo nënoficer prej këtu. Mendojmë se mund t'i dërgojmë pas një periudhe të caktuar, aq sa ju të kërkon!”.

Prek Previzi, e vërtetoi: “Ashtu shkëlqesi. Organizimi dhe plani i themelimit, si ai i përgjithshmi ashtu edhe i detajuari, mendoj për organizimin special të trupave të rregullta, përfshi edhe grupin kufitar të xhandarmërisë dhe vullnetarët, janë të gatshëm dhe shkojnë kapiten Deralla e kolonel Ali Shefqet Shkupi”.

Mehdi Frashëri: “Është e vërtetë se kemi paraparë përforcimin e policisë komunale dhe vetë policinë. Këto për ne përbëjnë fuqi të armatosura. E pash se ti Nexhmedin, kërkon që rinisë së grumbulluar dhe deri diku të organizuar, t'i jepet armatimi. Kërkesa juaj është më energjike nga plani i përgjithshëm, të cilin na e dorëzoi kapiten Deralla. Ai parasheh shërbimin në prapaskenë. A mendon se do të ishte më e mirë e juaja?”

Nexhmedini: “Ata këtë e kanë kërkuar, madje me lutje”.

Mehdiu: “Nuk do të ishte mirë që në të gjitha prefekturat, kjo çështje të zgjidhet në këtë mënyrë /kuptohet se duke marrë parasysh edhe rininë

vullnetare të fshatrave nga 16-17 vjeç, që do të varej nga aftësitë e tyre fizike deri në 20 vjeç/, të organizohen në shërbime të ndryshme dhe në prapaskenë, madje një pjesë e caktuar edhe për luftë. Mendoj se kjo është më mirë, ashtu edhe është paraparë”.

Me lejen e Mehdiut, fjalën e mori gjeneral Aqif Përmeti: “Përqindjen duhet ta përcaktoj komiteti. Anën teknike dhe komanda është e profesionistëve ushtarakë. Mendoj se është kështu, z. Nexhmedin, ndërsa ju kërkoni që komiteti të komandojë edhe teknikisht në beteja”.

Mehdiu: “Ashtu janë shprehur, mirëpo në atë kuptim komiteti është vetëm organ, i cili plotëson humbjet që të arrihet te fitorja. Ata do të jenë të organizuar, ashtu siç është paraparë me planin tonë, të cilin do t’ua japim”.

Gjeneral Prenk Previzi: “Nesër do t’ua japim në detaje!”

Për këtë, fjalën e kërkoi Asllan Boletini: “Në çfarë përmasash, shkëlqesia e juaj, duam të jemi të qartë, të na sqaroni z. gjeneral, ku janë kufijtë e përdorimit taktik e politik të ushtrisë sonë, dhe sa e në cilët komitete shfrytëzohen për përdorim politik që nuk janë të nënshtruar, sepse ka pasur raste që komandantët edhe të njëjsteve ekzistuese deri më sot të refuzojnë kryerjen e urdhrat të komitetit. Aq më tepër, nuk shkojnë as të bisedojnë, nën pretekst se ata e kanë komandën, dhe se komiteti është i themeluar për t’u dhënë ndihmë e asgjë më tepër. Tash dëgjoj edhe nga zotëria, prandaj dëshiroj të sqarohet”.

Mehdiu: “Ushtria e rregullt ka komandën e saj, nga lart ajo operon në bazë të një plani të përgjithshëm e parcial të komandës më të lartë. Mirëpo, edhe atëherë është në lidhje të ngushtë me administratën vendore, e që tash me autoritet të plotë politik të komiteteve vendore, të operojë nga vjeshta e deri kah mesi i janarit. Duhet t’u jepet në disponim komiteteve, jo në mënyrë të verbër, pa u përcjell, që të konstatohet se ku çon veprimtaria e tyre, mirëpo komiteti së bashku me administratën janë

ato organe që bartin përgjegjësi politike. Ushtria duhet patjetër t'u nënshtrohet. Përndryshe përse ta formojmë. E di se mbështeteni në rastin e Gjilanit, për të cilin rast kam shembullin e mirë, për gabimet e mëdha nga të dy anët. Komiteti i tejkaloi kufijtë, komandanti refuzon në mënyrë kategorike çfarë do lloj marrëveshjeje. Krijohen dy fronte: ushtria kundër vullnetarëve, që janë pasojë e informatave armiqësore në radhët tona, të cilët dëshirojnë që duke na thyer unitetin, të zotërojnë, madje duke na etiketuar si tradhtarë. Duke u parë sy me sy me ta, sa i përket problemit të mësipërm, mendoj se keni kuptuar, dhe përmes sqarimeve më të gjera për detyrën, kompetencën dhe lidhjen e njërit me tjetrin, do t'u ndihmojmë”.

Pas tij, e luti Xhafer Devën të marrë fjalën: “Në popull ekziston mendimi se unë jam i barabartë jo me një gjerman, por me njëqind, të cilët për nga përkushtimi nuk mund të barazohen me mua. Le të mendohet kështu, mirëpo unë nuk jam gjerman, siç nuk jam as rus apo serb, por vetëm shqiptar. Ne e dimë se çfarë po ndodh, se po ndryshohen rrethanat, mirëpo le të mendojnë ata ashtu. Këtu nuk ka vend për Stalinin, siç nuk e ka pas asnjëherë, e unë mendoj se ata janë në ëndërr. Të jeni të bindur se shumica nga e ashtuquajtura Lëvizja Nacionalçlirimtare do të na kthehet neve, sepse në prag të përfundimit, duan apo nuk duan komunistët, do t'i lëshojnë maskat nga fytyra dhe do t'u shihet fytyra e tyre e shëmtuar e tradhtisë. Se i kanë shitur trevat tona atyre që deri dje i mbanin të pushtuara”.

Deva, përmendi me emër e mbiemër, në mesin e tyre “më tradhtari ish-prefekti i Dibrës, Mehmet Hoxha, Fadil Hoxha” dhe emrin e një profesori, të cilëve “gjithsesi se populli do t'u pështyjë në fytyrë”.

Rifat Begolli: “Kjo gjithsesi se është e qartë, se pas ndryshimeve, ne jemi të zotët e situatës. Të njëjtit ata njerëz, të cilët deri dje brohoritnin për Stalinin, tash në Pejë shëtisin lirshëm dhe shumica kanë kaluar në organizatën e Drazha Mihajloviqit. Ata që shëtisin, pa mëdyshje se janë prapaskena, të njërës apo të tjetrës parti, ndërsa pa turp ka edhe prej

tanëve, të cilët, duke kaluar në mal, kanë kaluar në organizatën e Drazha Mihajloviqit dhe gjenden me ta”.

Pasi që te Mehdiu ishin Hysni Dema, Fiqri Dine, fjalën e kërkoi Fiqriju: “Unë do të flas për Dibrën, ku situata për shumë çka është në disfavor të partizanëve. Të mos i numëroj, vetëm katër familje janë nga vetë Dibra, të cilat e kanë nënshkruar aktin e tradhtisë dhe e kanë pranuar etnicitetin maqedonas dhe neve si “pakicë”, me çfarëdo të drejtash qofshin ato. Nuk mund të besohet se një dibran i ndershëm do të pranojë një akt të tillë, nëse këtë e ka të qartë. Shikoni tradhtarët, gënjejnë, mashtrojnë, dhe si rrjedhojë për çdo ditë na bashkëngjiten neve. Për mua nuk është aspak e habitshme që të na bashkëngjiten edhe Haxhi e Aqif Lleshi, sepse për ta unë garantoj se nuk janë komunistë, por njerëz që e shesin vetveten cilitdo qoftë, vetëm se të arrijnë diçka për veten e tyre. Për Dibrën ju mos u brengosuni, por mendoj se duhet pritur nga dibranët ashtu të bashkuar nga djemtë e tyre të formojnë ushtri apo aradhe dhe të vijnë te ne, sepse këtu e kanë vendin. Aq më tepër se e di që nga oficerët dhe nënoficerët dibranë mund të formohen tre batalione”.

Gajur Deralla: “Nëse në çfarëdo situatë do të ngelin të gjithë kundërshtarë, e përse të mos ngelin, nëse ju me vendosmëri pohoni”.

Fiqri Dine: “Është e vërtetë!”

Deralla: “Unë kam deklaruar edhe herave të tjera se njëri është zogist, tjetri tregohet si ballist, ndërsa të dy vëllezërit e tjerë të LNÇ-së. Për çka ne sot të gjithë të mësipërmit i dënojmë. A nuk është kjo e vërtetë!”

Askush nuk përgjigjet.

Gajur Deralla: “Në Dibër janë të paktë ata që me vetëdije e shet tjetrin, jo të mirin, por edhe më të prishurin e atdheut tonë. Unë them se janë jo katër familje, por në numër më të madh. I pari është vëllai i Hysni Demës, Hamdiu”.

Mehdiu: “E gjithë kjo na është e njohur”.

Xhemë Hasa: “Po zotëri /i drejtohet Mehdi Frashërit/, nuk dua të di gjithçka, por nuk dua të vdes pse të dua ty, por për lirinë. Dua ta siguroj dhe dua ta di edhe atë që ti e di”.

Mbretëroi qetësia. Vazhdoi sërish Xhema: “Aspak nuk jam penduar që e krijova këtë /mendonte për heshtjen/. Erdhën italianët, ju me ta, pastaj gjermanët sërish ju dhe ne me ta, e në anën tjetër ju me LNÇ-ë. Me njerëzit tuaj, ju me anglezët, a janë anglezët te ju? Kështu më tha Gajuri dhe askush nuk duhet ta dijë, përveçse kuptohet, ju. Atëherë e dini “Vetë agë - vetë pashë, vetë vezir - vetë kadi!”. Ne asgjë s’duhesh të dimë, vetëm të vdesim. Unë mendoj se duhet ta di atë që e di ti z. Mehdi, aq di, aq kam për të thënë”.

“Ju i keni thënë Xhemës?”, m’u drejtua Mehdi Frashëri.

Unë: “Në këtë drejtim kemi biseduar edhe më gjerë”.

Mehdiu: “Për çdo vendim do t’ju njoftojmë edhe juve”.

Përsëri unë: “Me shekuj jam luftëtar i lirisë në mbarë krahinën time. Nuk ka kurrfarë të drejte që mua të më ofrohet diçka e të zgjidhet pa mua, por vetëm me mua. Në tavolinën qarkore, nuk pranoj privilegje”.

“Të këtij mendimi jemi edhe ne”, thanë Mehdiu dhe Rexhep Mitrovica, për të vazhduar: “Gjithashtu e kanë ditur edhe njerëzit tuaj, por nuk u kanë treguar”.

Unë: “Ju lutem, kjo të ndërpritet!”.

U kuptua se neve na u bë e qartë, se dëshirohej të mbahej fshehur nga gjermanët, prandaj nuk dëshironin të flasin hapur se kanë njerëzit e tyre të shpërndarë gjithkund.

Mehdiu: “Ju jeni ushtar dhe nuk do të jeni në gjendje të merrni pjesë këtu. Tash për tash nuk them asgjë, por ai që do të vijë mund të

flas, jo siç dëshiron me mua apo nën ndikimin e ndonjë individi, por duhet patjetër të jetë korrekt”.

Xhema: “Kjo është dëshira e popullit”.

Mehdiu: “Unë gëzohem për këtë”.

Xhema: “Unë mund t’u them jo vetëm se jemi të aftë ta mbajmë tash për tash atë territor në qetësi, por me fuqi të mëdha t’ju vijmë në ndihmë juve. Struga, Reka, Gostivari, Tetova, Kaçaniku, Shkupi, Kumanova, kur të duan mund të kalojnë kufirin, mund të vijmë deri më 10.000 vetë”.

Mehdiu: “Edhe kjo do të ndodhë, në radhë të parë të jemi të qetë”.

Nga personalitetet me ndikim nga Shkodra që gjatë kohës së Italisë ishte prefekt në Vlorë, Jup Kazazi, propozoi që edhe nga veriu edhe nga jugu të bëjmë grumbullimin e ushtrisë në njësi vullnetare sa më parë, duke shtuar: “Rezerva jonë më e madhe vullnetare, veç vendeve të tjera, është edhe Dibra. Të mos e harrojmë as Tiranën dhe krahinat veriore. Unë aspak nuk i llogaris komunistët, mund të them se ata edhe me veprimin e tyre janë të dobët, sepse mbisundon përçarja dhe për një moment të paramendojmë që ata t’i marrin viset tona, nuk do të bënin asgjë, sikurse drazhistët. Me këtë nuk dëshiroj t’i mbroj ata, ajo ide u shërben vetëm sllavëve të zotërojnë me botën, prandaj është detyra jonë, posa t’i pastrojmë këto krahina e t’i përforcojmë kufijtë, atëherë fuqitë rezervë t’i mbajmë në Dibër e Lumë”.

Halil Alia: “Në radhë të parë ne dibranët duhet të pajtohemi së paku përkohësisht, në prezencën e të gjithë juve, në emër të kombit dhe shpëtimit. Lus të ndërpritet armiqësia për momentin e deri në mbarimin e luftës. Tjetër, posa ta kryejmë këtu, siç tha Kazazi, lus shkëlqesinë të jem nën komandën e tij, me atë të jemi në kufi, ku do të jetë nevoja, tha në gjuhën shqipe: “Nuk kam pas asnjëherë qëllimin me u ba, por për atdheun punë me ba”. Ja, unë, dje i varfër e sot i pasur, gjithçka çfarë kam e lë në disponim ekselencës suaj dhe atdheut. Dëshira ime është t’ju

shoh juve përpara, ne me fjalën tuaj do të gjendemi në flakë, në vdekje të ndershme”.

Duke iu drejtua Prenk Previzit u shpreh: “Kam dëgjuar një vjershë të hartuar nga Deralla që në kohën e qeverisjes së mbretit Zog, të cilën e këndonin ushtarët gjatë marshimit, e cila është si më poshtë:

Tungjatjeta nëna jonë,

Tungjatjeta përgjithmonë.

Mos u tremb prej askujt,

Kemi me i dhënë shkelmin të huajit,

Se për ty luftojmë e vdesim të tanë.

Unë jam i gatshëm të vdes edhe nën komandën tuaj si ushtar, me këtë mendoj se kam thënë gjithçka dhe iu përgjigja Gajurit dhe Xhemës, se Dibra nuk dëshiron privilegj dhe hegjemoni”.

Gajur Deralla: Megjithëse të gjithë dibranët nuk mendonin si ai, Rifat Begolli insistonte t’i përgjigjem: “Nuk e kam sulmuar Dibrën e as që e kam tepruar kur fola për Fuat Dibrën, ta përshkruaj flijimin e tij për atdheun. Nuk jam i gatshëm, më gëzon fakti që ti je i gatshëm për gjithçka”.

U bë pajtimi, ne u shpërndamë.

Pas largimit të Mehdiut, në sallë, në një skaj, u ndalën gjeneral Prenk Previzi, Fiqri Dine, Xhemal Keleshi dhe Halil Alia dhe i paftuar u afrova dhe unë, Rifat Begolli, Rexhep Mitrovica, pas nesh vijnë Xhaferi, i hidhëruar, i vendos syzat, i thotë me zë Fiqri Dines: “Paramendo, si ministër i punëve të brendshme në atdheun e tij, të jem i detyruar të eci në këmbë!”.

Me këtë përfundoi mbledhja, ku u emërova të themeloj batalionin, pa ndonjë imponim detyre të rëndësishme partiake, e as të thirrem në parti. Duke e pranuar elaboratin e nevojshëm dhe të kufizuar organik, u ktheva në Tetovë së bashku me komitetin e Tetovës.

Menjëherë pasi u kthyem, komiteti m'i dorëzoi këto personalitete: për oficer, Yzair Yzairi, Harun Dehari, Sami Narazani. Unë insistoja të përfshihen edhe Nazif Zekiu, Hilmi Miletini, Ali Rahmiu dhe Mexhait Gajra. Të sipërpërmendurit morën gradën toger, ndërsa të tjerët nëntogerë dhe flamurtarë, që gjithsej ishin 54, gjithashtu edhe nënoficerë.

Ashtu siç qe përcaktuar, komiteti lëshoi urdhëresë. Fshatarët i dhanë kuajt e tyre dhe nën komandën e togerit Yzeir Yzeiri, Harun Dehari dhe Mexhait Gajra, çdo herë nga 500 kuaj sollëm materialin nga Prizreni nëpër Sharr dhe me automobila të komandës së divizionit në Prishtinë, gjashtë herë nga dy deri më gjashtë kamionë nëpër Kaçanik dhe Shkup: bar, kashtë, dru, i merrnim nga komiteti. Doktor Xhafer Sulejmani dha /nuk më kujtohet shuma e saktë/ ndihmën e parë nga arka komunale, mendoj 2.500 franga për meremetimin e kazermës. Në afat prej tetë ditësh, më 28 nëntor, në Tetovë, komiteti dhe batalioni në përbërje të plotë prej 1.200 ushtarësh organizuam ceremoni dhe kryem një paradë para qytetarëve dhe dhamë betimin. Me këtë rast, Shaip Kamberi mbajti fjalim, duke folur për 28 Nëntorin si një ditë historike dhe detyrën e sotme të ushtrisë sonë. Në mbrëmje u shtrua darkë për oficerët, anëtarët e komitetit dhe personalitetet e shquara, së bashku me hoxhallarët në krye me Hafëz Xhemilin, me ç'rast Shaip Kamberi sërish mbajti fjalim. Po e paraqes fjalimin e tij të parë, jo shkronjë për shkronjë, por ajo çka ende më kujtohet:

“Ushtarë, nënoficerë dhe oficerë. Para jush janë prindërit tuaj më të dashur, para jush është i tërë populli, simboli i lirisë - flamuri ynë heroik, i njëjti ai i cili shekuj me radhë mbahej nga beteja në betejë në duart e djemve trima si ju, të cilët me jetën e tyre mbronin atdheun tonë të dashur edhe atë shumë herë duarthatë, por e kanë mbrojtur. Ja edhe juve ju erdhi radha që në hap t’i trashëgoni paraardhësit tuaj, duke pasur të njëjtin flamur, ta mbronin atdheun tonë të dashur”.

“Unë jam i bindur se asnjëri nga ju nuk do ta kursejë veten për të mirën e atdheut. Tash ka ardhur koha ta dëshmoni para tërë botës se Ilirët ende janë gjallë dhe shumë më të fortë për të mbrojtur gjithçka çka është e tyre. Ka ardhur koha që kësaj lirie, duke i dhuruar jetën tonë, ta sigurojmë si për ne ashtu edhe për ata të cilët edhe sot vuajnë nën thundrën e të huajve përtej linjës së demarkacionit. Ka ardhur koha që gjithkund deri te kufijtë etnikë të jehojë kënga në gjuhën tonë të dashur dhe ky flamur kuq e zi, të valojë në qiellin shqiptar. Të gjithë së bashku nga 17-70 vjeç, madje edhe nënat e motrat tona të japin jetën për realizimin e idealeve”.

“Përderisa unë flas, jam i sigurt se përmes linjës së demarkacionit, sërish vëllezërit tanë e përcjellin me vëmendje punën tonë. Ata neve na shohin. Janë të gëzuar dhe të gatshëm të ngrihen në momentin tonë më të vogël, edhe pse nuk kanë armatim, duarthatë. 28 Nëntori, pas shekujsh robërie u bëri me dije tërë botës, se ky komb nuk vdes. Se është e pavërtetë se këtu jetojnë kolonizatorët, porse jemi ne pasardhësit e Pellazgëve e Ilirëve, këtu ka një grusht ardhacakësh kolonizatorë nga viti 1912, një grusht tjetër janë turqit të cilët mund të numërohen në gishta dhe, e treta, se ne dimë turqishten dhe jugosllavishten, por nuk jemi turq e as sllav, ne jemi zotëruesit e tokës sonë”.

“Armiqtë tanë përmes gënjeshtreve të ndryshme dëshirojnë të na e thyejnë bashkimin, dëshirojnë të na paraqesin si armiq të kombit. E kush janë ata të cilët deri dje na mbanin neve nën pushtim, e sot i kanë mashtruar vëllezërit tanë, me qëllim që të na dobësojnë neve që sërish ta

krijonë Jugosllavinë. Siç mendoj unë, ashtu edhe të gjithë të tjerët, përveç të mashtruarit dhe tradhtarët, aq sa janë, nesër do ta marrin atë që e meritojnë”.

“Si i deleguari i Qeverisë së Tiranës dhe i Komitetit, këtu po ua dorëzoj pushkët, duke ju dëshiruar gëzim të këthillë në punën tuaj, dëshiroj t’u përgjigjeni gënjeshtreve dhe tradhtarëve se ata nuk mund ta adhurojnë atdheun tonë më shumë se ne. Le të rojë simboli ynë i lirisë dhe krenaria e heronjve tanë kombëtarë, flamuri ynë, do të jetojë me shekuj në atdheun tonë të lirë, dhe do të jetojnë emrat e heronjve të rinj!”.

Pas kësaj, unë i rreshtova ushtarët para betimit dhe mbajta një fjalim të shkurtër, midis të tjerave, u thash oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve:

“Së pari, në emrin tuaj e më pas së bashku me ju, duke e lexuar betimin, para nesh paraqitet nevoja që për atdheun ta japim edhe jetën. Me këtë nuk do të bëjmë asgjë tjetër vetëm se përgatitjen e një guri prej graniti, për një monument të lartë të heronjve të panjohur, që ndërtohet me eshtrat e paraardhësve tanë, duke filluar nga Pellazgët e deri më sot. Do ta drejtojmë pushkën dhe bajonetën kundër çdokujt që në mënyra të ndryshme na del para rrugës”.

Pas meje, në emër të rinisë /meqenëse ishte më herët anëtar i organizatës rinore, oficer/ foli Sejdi Bajrami. Pak më kujtohen fjalët e tij, sepse nuk pati përgatitje e as që ma dorëzoi tekstin. Në paradë mori pjesë edhe organizata rinore, me dy çetat e veta, të përbërë me nga 100 të rinj, xhandarmëria dhe trupat kufitare nën komandën e kapitenit Qazim Lusha.

Kishin kaluar 60 ditë, kur batalioni u plotësua numerikisht me personel, pushkë, mitralozë të lehtë italian dhe me një çetë me armatim të rëndë, mitralozë dhe minahedhës të rëndë. Kështu kishin ngelur edhe 60 ditë, për të cilën kohë duhej të krijoheshin, siç vura në dukje më sipër,

së paku katër batalione dhe njësi lëvizëse. Komiteti u përgjigj obligimeve të veta, nuk më kujtohet data, mirëpo duhej të ishte rreth 20 shkurtit. Në Tetovë erdhi delegacioni i përbërë nga nënkoloneli Hysni Dema, Ali Maliqi, Kaloshi, emri nuk më kujtohet /komandant i xhandarmërisë në Dibër i vrarë në luftimet me partizanët në Dibër/, avokat nga Dibra, emri i të cilit gjithashtu nuk më kujtohet, e di se gjatë kohës së Italisë ka punuar së bashku me Shaip Kamberin si avokat në Tetovë. Unë për ardhjen e tyre nuk dija asgjë.

Ngjarja ishte zhvilluar në këtë mënyrë: kishin ardhur në nënprefekturë te Shaipi, e kanë sjellë porosinë e Mehdi Frashërit dhe kanë insistuar të tubohet komiteti, edhe atë në atë moment. Kuptohet se Shaip Kamberi, i cili ishte marrë vesh më herët me Xhemën, Mefailin, Memishin, që me urdhër të Mehdiut, batalioni t'u dorëzohet oficerëve, të cilët do të vinin. Mënyra e ardhjes së tyre nuk ishte sqaruar. Ka pranuar të mblidhet komiteti, mirëpo pasi kishin qenë të tubuar Shaip Kamberi, Sherif Mina, Hoxhë Ahmet Efendiu, Mehdi Mustafa, asaj kohe i emëruar komandant i xhandarmërisë dhe i ngritur në gradën kapiten i klasës së dytë, drejtori i monopolit, një katolik nga Shkodra, emrin e kam harruar, Nexhmedin Besimi, ku duhej të përcillej urdhri i Mehdi Frashërit me një këshillim paraprak: Po, ishin Arifi dhe Memishi te nënkoloneli Hysni Dema. Me këtë nuk ishin pajtuar hoxhë Ahmet Efendiu nga Çajla, Sherif Mina dhe Jusuf Kuliku, duke u kërcënuar se ata mund të largohen, nëse nuk do të ftoheshin edhe unë. Më në fund, nënkoloneli kishte pranuar dhe unë u ftova. I gjeta në zyrën e vogël të ndërtesës komunale /rruga e Shkupit/. Gjatë rrugës u informova nga policia për ngjarjet e zhvilluara. Me hyrjen time brenda, nënkoloneli si në shaka tha: "Ja, më në fund edhe ju. Ne për ju kemi ardhur".

Iu përgjigja: "Shekuj me radhë nuk ka mundur pa mua e as që do të mundet. T'i dhe bashkëmendimtarët tuaj mund të ëndërroni, vendi im nuk është këtu".

U tërhoq zotëria, drejtor i Monopolit, në të majtë dhe më liroi vend. Fola: “Unë të dëgjoj se çfarë ka të re”.

Nënkoloneli iu drejtua Shaipit, duke dashur të më bindë, më kërkoi leje: “Shaip, ja Gajuri e filloi!”

Unë: “Po, unë e fillova!”.

Nënkoloneli: “T’i je prefekt, sepse ashtu kam dashur unë, lehtë mund të të largoj”, dhe filloi të qeshet.

Unë iu përgjigja: “Nuk kam kohë dhe urdhëroj që të shpërndaheni. Nuk dua të them, por ai që qëndron pas kësaj, le të shpërndahet!” Të njëjtit që më kishin kërkuar u ngritën dhe duke m’u lutur e me insistimin e anëtarëve të tjerë, të cilët kishin ardhur nga Tirana, unë u pajtova. Dhe, Hysni Dema filloi. Unë nuk mundem shkronjë për shkronje ta përcjellë fjalimin e tij të parregullt /më i parregullt se i imi sot/, mirëpo do ta mbaj mend deri sa të jem gjallë pikat që ai foli në emër të dëshirës së Mehdi Frashërit”.

“Duke na bërë neve të papjekur, dëshirën që batalionin e krijuar t’ua dorëzojmë oficerëve, në radhë të parë dibranëve /aty prezent ishte edhe Qazim Lusha/, e dija manovrimin e tij, atë e kuptova përmes Dervish Lushës, babanë e tij me ndikim tek Mehdiu, shprehet: “Nëse është e mundur që oficerët nga Shqipëria e vjetër, të formojnë batalion. Xhandarmërinë lëvizëse, gjithashtu nga oficerët dhe nënoficerët nga Dibra dhe Shqipëria e vjetër. Të ndërrohen kryetarët e komunave!”, me kërcënimin se “kjo duhet detyrimisht të kryhet!”

Nuk desha asnjërit t’i jap kohë të përgjigjet, u përgjigja unë në këtë mënyrë: “Në cilën do cilësi që ke ardhur, unë ty të them, batalionin nuk do ta marrësh në duart tuaja e as që mund ta marrësh xhandarmërinë. Ndërsa kryetarët e komunave, aq sa janë, kanë ardhur edhe të papërgjegjshmit, të paaftët, ne do t’i ndërrojmë. Ja, njëri në hotel, i dehur, i cili e ka emrin Tërshana, lirisht le të vijë me ty. Nëse Mehdi

Frashëri është i këtij mendimi, atëherë ai është provincialist, mendjelehtë ose të frikohet ty, apo më mirë të them rolin tuaj vendimtar, unë dhe oficerët e mi nuk frikohemi, e refuzojmë dëgjueshmërinë!”

Të nesërmen, u organizua mbledhje e zgjeruar, Balli Kombëtar dhe autoritetet mbarë, të gjithë prezent, përveç Hafëz Xhemilit, në moshë, të cilin e kishin ftuar, por nuk erdhi. Gjithashtu nuk erdhi edhe Teki Selenica, kryetar i Gjqyt të Qarkut, ndërsa Baba Qazimi mosardhjen e tij e arsyetoi me sëmundje.

Unë grumbullova komandantët e çetave: Hilmi Miletinin, Harun Deharin, Yzeir Yzeirin, Idriz Ibrahim-Cërcërin, Sami Narazanin, Izet Aliun, Ali Rahmiun, intendentin dhe ndihmës adjutantit, nëntogerin Sejdi Bajramin. Në pika të shkurta u thash për qëllimet e Tiranës, se është ndërprerë dhënia e armatimit e sende të tjera, pajisja për lidhje; se qëllimi krahas dyshimit është se nuk do të jemi besnikë, siç edhe nuk do të ishim për disa, që dëshira e tyre është të na përjashtojnë. Unë jam i mendimit që të mos e dorëzojmë batalionin. Kam dërguar njerëz në Gostivar dhe do t’i pyes para jush, komandantëve të çetave, se a është ndalur në Gostivar komisioni i Tiranës dhe me cilin ka biseduar, gjithashtu do ta pyesim edhe Strugën e Kërçovën, ndërsa korrierët do na sjellin raporte të detajuara. Ne në bazë të bisedimeve gojore, mund t’i ndërmarim masat e nevojshme.

Urdhërova çetën në Gostivar për gatishmëri, nëse insistojnë të dorëzohen, të luftojnë kundër çdokujt. Të nesërmen, na ishte e qartë se jemi të vetmuar, komiteti u tubua, autoritet, të gjithë aty, gjithashtu edhe unë. Nuk lejova që dikush të flet. Komiteti i Tiranës sërish ishte prezent. Fola unë, se nuk e dorëzoj batalionin, nuk lejoj formimin e njërive të reja jashtë planit të miratuar. Me mënyrën siç dëshirohet, nuk mund të ndërrohet administrata komunale. E shkarkoj prefektin, duke e marrë pozitën e tij. Pyes, a keni diçka kundër?

Zëshëm: “Nuk lejojmë që të përbuzemi me atë që fëmijët tanë janë qyqarë, këta le të shkojnë nga kanë ardhur”, thotë Jusuf Kuliku.

Jakup Aga përsërit: “Këtu gjithçka do të shkojë me të vjetrën, madje edhe më mirë, do të japin dyfish më shumë për ushtrinë tonë”.

Abaz Mujedini shton: “Mbushni xhepat, torbat, qeset me para, kjo për ju është dashuria ndaj atdheut, mirëpo nuk do të ketë më çiflig për ju!”

“Më kujtohet mirë!”, tha i moshuari Abaz Efendiu: “Në vitin 1912, komandanti i divizionit vullnetar Mehmet Pasha, kthehet përmes Kaçanikut në Tetovë, i fton këta për ndihmë. Babai i tij, tradhtari Dine Dema iu dorëzua serbëve, për para nuk vjen, por kërkon nga Mehmet Pasha që së bashku me ushtrinë të vazhdojë tërheqjen deri në Dibër. Ku do të ngelte mbrojtja. Ja sërish ata në krye kanë ardhur, nëse nuk mund të na shesin, së paku ta shpëtojnë vetveten. Përshëndete edhe Mehdiun tënd. Nuk do ta ketë lehtë nëse nuk tërhiqet nga ky vendim”, tha Abaz Efendiu.

Me këtë mbaroi, dhe unë me shokët e mi oficerë, vendosëm për regjistrimin e gjithë asaj që ka në tetë komuna, dhe i propozuam komitetit. I dërgova oficerët në të gjitha komunat, ku qëndruan thuhet 7 ditë për regjistrim. Duhej dezertuar ushtrinë nëpër komuna dhe fshatra. Me shpejtësi të krijonim këshilla vullnetare, politike e ushtarake, të përgjegjshme, si dhe Komitetin Kryesor Operativ.

Më kujtohet se Abdulla Sulejmani /nëntoger/, që dërguar në komunën e Zhelinës, mirëpo në atë kohë erdhën oficerët nga Tirana për ta marrë batalionin në duart e tyre. Për komandant të batalionit që dërguar major Aqif Goli, për ndihmësin e tij të parë, kapiteni Vehap Dodxhiu dhe 8 oficerë të tjerë. Menjëherë u paraqitën në kazermë. Unë i tubova komandantët e çetave dhe në prezencën e tyre, të majorit, thashë si vijon: “Ke ardhur ta pranosh batalionin që është krijuar, sikurse e di edhe ti, në bazë të marrëveshjes, dhe prandaj unë nuk ta dorëzoj. Mund të kthehesh!”

Si përgjigje mora këtë që vijon: “Unë jam ushtar, zbatoj urdhrin, di gjithçka e diç më shumë se ti për ndryshimin e situatës, prandaj unë do të të pres. Ti shko në Tiranë, takohu me gjeneral Prenk Previzin dhe do ta kuptosh. Mund të më thuash, përse unë nuk të tregoj së paku në katër sy. Ke të drejtë, kur nuk e di peshën e ndryshimeve. Mund të paramendosh se unë të dërgoj në teh të mprehtë, mirëpo do të ngeli këtu si garanci, m’u në duart e ushtarëve tuaj. Mos u befaso aspak, përse Xhema, Mefaili dhe Shaip Kamberi nuk janë të qëndrueshëm, megjithatë ke aq fuqi nëse nga unë do jesh i mashtruar, të më likuidosh. Duhet të shkosh nëse ke pak ndjenja ushtarake!”

Në emrin tim, togeri Yzeir Yzeiri iu drejtua majorit: “Krejt kjo është ndërkëmbëz, mundej kjo të zgjidhej pa ardhjen tuaj, ne nuk e dorëzojmë batalionin!”

A është kështu, më pyet mua: “Nëse je shurdhmemec, po e përsëris edhe njëherë, po”.

Përreth kazermës qenë tubuar mijëra qytetarë dhe fshatarë. Ai doli nga kazerma. Fshatarët insistuan që unë të deklarohem se përse kanë ardhur, përse duan ta marrin batalionin. Pas gjysmë ore, edhe rinia që e gatshme.

Nexhmedin Besimi vjen në kazermë, më lutë që të mos paraqitem para popullit, sepse do të jetë keq për Tetovën, do ta djegin. Nuk e dëgjova, u nisa me grupin e oficerëve të mi drejt ndërtesës së nënprefekturës dhe nga ballkoni njoftova masën e tubuar se nuk e dorëzojmë batalionin, për shkak se “Tirana dëshiron të na ofendojë, nuk qëndron pas fjalëve të veta, dëshiron që me çdo kusht t’i plotësoj dëshirat e individëve të caktuar, të cilët janë të shitur. Ushtria është krijuar për mbrojtjen dhe shpëtimin e atdheut dhe për operimin jashtë kufijve të saj”.

Masat e gjera mirëpritën këtë. Pati edhe disa njerëz të futur, me qëllim të krijimit të përçarjes krahinore, të cilët mu afër ballkonit brohoritën: “Poshtë dibranët!”

Iu përgjigja menjëherë: “Ti je i futur, shërbëtor i papërgjegjshëm, dibranët janë vëllezërit tanë!” Masa, për disa minuta me radhë, insistonte që me çdo kusht të mos e dorëzojmë batalionin dhe më pas u shpërnda. Menjëherë pas kësaj, majori Aqif Goli u nis për në Tiranë, për t’u kthyer pas 10 ditësh. Unë vazhdova me organizimin e fshatrave, siç vura në dukje më sipër. Kuptohet se, për këtë ishin njoftuar Shaip Kamberi me shokët. Filloi kundër-propaganda, se unë jam në lidhje me LNÇ-në, përkatësisht komunist i maskuar. Unë edhe tash mund të them lirisht se nuk kam qenë, ndoshta kam qenë njëri ndër ata i cili kam dëshiruar që mosmarrëveshjet të tejkalohen dhe sa më parë të shkonim në luftë kundër pushtuesit, e jo në momentin e fundit”.

“Qëllimi im ishte që në start, sa është e mundur, t’i jap një grusht të fortë, dhe të vazhdoj me fuqinë e njëjtë. Besoja se me vullnetarë të shumtë mund të organizonim një kryengritje të përgjithshme nga Gostivari gjer në Strugë, për 2 muaj të krijonim zonë të lirë. A do të vepronim sipas zhvillimit të ngjarjeve, kuptohet as çfarë kompromisi me gjermanët. Mirëpo, kjo nuk ishte punë e lehtë, sepse frikoheshim se mos i jepej urdhër ushtrisë bullgare të marshonte. Kudo nëpër fshatra, ata të cilët e kishin lexuar shkrimin e njëfarë gazetari, Gjeorgiev, ku nga Sharri e poshtë emërtonte si tokë bullgare dhe mbështetej te Hitleri, premtonte se së shpejti do të futet në ato krahina nëna Bullgari /kjo ishte në “Maqedoninë” e atëhershme”.

Përgjigja ime ishte si vijon: “Në ato krahina, madje edhe në Shkup e Manastir, jetojnë shqiptarët etnikë, pasardhësit e ilirëve”.

Unë nuk thirresha në Hitlerin e Musolinin, por shpreheshja se “së shpejti fuqia e drejtësisë do të krijojë çudira për të gjithë ata të cilët mendojnë që në një apo mënyrë tjetër dëshirojnë të na shkelin në stomak, dhe se Shkupi e Manastiri, sërish do të jenë Iliriane”.

Kuptohet se shkruaja nën nofkën “Trashëgimtari i Ilirisë”. Fshatarët kudo, madje edhe në vetë shtëpinë e Shaip Pirroikut, ku qesh ftuar dhe iu

përgjigja ftesës, flisnin për atë. Me mua ishte togeri Harun Dehari, Nazif Izet Halimi, aty nga Kamjani ishin dy veta, emrat e të cilëve nuk më kujtohen, nga Bogovina Iliaz dhe Ali Bogovina dhe nga fshati Reçicë, Hafëzi ish-deputet i popullit në atë komunë. E kishin dërguar nëntogerin Isa Tresi, të cilin fshatarët, madje edhe vetë Shaipi e mbante mirë, ndërsa nga ana tjetër për tërë aktivitetin tim njoftonte Tiranën. Arifi ishte i mendimit tim, ai kishte një numër të vogël të arratisur nga Bullgaria.

Dhjetë ditë më vonë sërish vjen majori. Me ndërmjetësimin e Shaipit (Pirrokut-Q. L.) insiston të dorëzojmë batalionin. Unë me oficerët dhe me mua edhe vëllai i Shaipit, nuk e dorëzojmë batalionin. Sërish tubohet masa. Unë në krye të batalionit kaloj nëpër rrugë, me manovrimet të natës në drejtim të Gostivarit. Nga masa marr mbështetje të fuqishme, që përsëriste: “Nuk e dorëzojmë batalionin dhe le të krijojnë edhe ata!”

Të njëjtën ditë, majori sërish kthehet për Tiranë. Unë i bindur se janë krijuar kushtet, u nisa për në Shkup, me automobil, së bashku me adjutantit, togerin Nazif Izet Aliun, me qëllim të takohem me Abdyl Durrën. Së pari e pashë hoxhën nga Kaçaniku (Ismail –Q. L.), në trotuarin e shtëpisë së oficerëve. Me të ishte një i ri, i pa njohur për mua. Iu drejtova hoxhës, i cili më pyeti përse kam ardhur? I thash se ka ardhur koha të ngrihem në kryengritje, dhe kërkova mendimin e tij. Duke mos e pritur përgjigjen i thash: “Gjermanët së shpejti do të fillojnë të tërhiqen kah Greqia. Të gjitha rrethanat na bëjnë me dije se ka ardhur koha, të konsultohemi për ditën kur së bashku do ta sulmojmë Shkupin, sepse vendet e tjera për ne nuk paraqesin asgjë. Nëse dëshiron të kesh ushtri të organizuar në duart tuaja, mu në këtë moment dërgoi njerëzit tuaj tej kufirit. Unë do t’i stërviti dhe në momentin e dhënë janë të tuajt”.

Hoxha u përgjigj: “Kjo është e mrekullueshme, por a ka ardhur vërtet momenti, atë që ju më thoni mua?”

“Të them, miku im /duke iu drejtuar të riut, derisa ndërhyr i riu/, mendoj se ka ardhur koha”.

Mora fjalën unë, sepse hoxha i thelluar në mendime heshte: “Pikërisht është momenti i fundit, që është i dobishëm. Në anën tjetër, nuk mundet asgjë të kryhet pa organizim, duhet përgatitje e vëmendshme dhe e mirë”.

Kur e vërejti se jam i vendosur tha: “E pranoj. Të jesh i bindur, do të angazhohem që në këtë anë, që nënkupton zonën pushtuese bullgare, të përgatis vend për mbledhje me njerëzit e mi, në atë mënyrë që së bashku me Arifin apo eventualisht me Tahirin, ilegalisht të vish edhe ti!”.

Unë këtë ofertë e pranova. “Tash shko takohu me Abdyl Durrën te Hani i Ali Beut, do ta gjesh ose atë ose Abdyl Odrinë”, më tha në fund hoxha i Kaçanikut.

Unë dhe togeri Nazifi u drejtua kah Hani i Ali Beut, ku pas një kohe shumë të shkurtër kaloi Abdyl Odria. E luta të shkojmë lart në një dhomë, ky pranoi dhe në prezencë të Nazifit, menjëherë filluam. Sipas mendimit të tij, mundeshim të depërtojmë dhe të përgatisim së paku 2.000 të rinj nga Kaçaniku, Shkupi, rrethina e Kumanovës. Gjatë zbritjes, para derës së hanit /Abdyl Odria ende ishte lart/ takuam Abdyl Durrën, hymë në një çajtore turke. Unë e përsëris gjithçka, kurse ky pa u menduar fare tha: “Unë jam i gatshëm. A ke biseduar me ndonjë?” I thash se kam biseduar me hoxhën dhe më dërgoi te ju. Në atë çast erdhi edhe Abdyl Odria. Që të dy vendosën që së pari të ketë mbledhje të gjerë ilegale. I lus të më kontaktojnë me Qemal Beun nga Shkupi, edhe atë për një kohë të shkurtër, nëse është menduar /nuk mendoj për orë/.

Të dy më premtuan, me pretendime se e njohin dhe se është patriot i mirë. Gjithashtu premtuan se me vete do ta marrin në mbledhje edhe Sulë Hotlën dhe të tjerët nga fshatrat e Shkupit.

Kur u ktheva nga Shkupi, te unë në kazermë erdhën Shaip Kamberi, Sherif Mina, Hoxhë Ahmet Efendiu /për mua njeriu më i çmendur/ dhe më thanë: “Ke qenë në Shkup dhe çfarë ke biseduar?”.

Nga mbledhja ime në ora tetë të mëngjesit kishin kaluar 10 orë, që Abdyli të dërgojë njeriun e tij. Kur unë vërtet e pash se ata janë tërhequr nga ajo, se ajo ka qenë një huti e tyre dhe nuk llogarisja tek ta dhe se ata nuk janë me mua, përkatësisht se do të luftojnë për ta ruajtur batalionin në Tetovë, unë ngela i vetmuar së bashku me oficerët e mi.

Duhej shkuar përmes rrugëve të tjera: ta lësh batalionin apo të qëndrosh pas tij? Konsideroja se së paku duhej dorëzuar në duart e sigurta. Një njeriu që e njihja mirë, nënkolonel Neshat Kolonja, i cili me batalionin pati luftuar kundër italianëve në Vlorë gjatë ardhjes së italianëve dhe i cili në prag të kapitullimit të fashizmit me batalionin u arratis nga Miloti, me çka batalioni ynë që shpërbërë me urdhër të Mitatit dhe Mehdiut.

I bindur se do ta përdor dhe se do të më tregojë gjithçka çfarë dinë dhe çfarë mendojnë, sepse me ta ishte i afërt, ndërsa në momente më të vështira shpesh herë më mbështeste mua /këshillohej/ për ta tejkaluar rrezikun, me qëllim që të mos e zhdukim pa gjakderdhje. Me vete mora rreth 40 ushtarë të zgjedhur vullnetarë dhe oficerë. Nga oficerët ishin: Ali Rahmiu, Hilmi Miletina, Nazif Izet Aliu dhe Yzeir Yzeiri. Nga vullnetarët: Arif Kapiteni, Tahiri, Memish Bukoviqi, Shefqet Arnaqia, si dhe truproja ime dhe ushtarë dhe vullnetarë të tjerë.

Gjatë udhëtimit përmes Gostivarit, Kërçovës dhe Strugës ftova Xhemën, Mefailin dhe Remzi Beun, të cilët refuzuan të vijnë. E kisha të qartë se jam i vetmuar. Shkuam drejt në Tiranë. Duhej paraqitur në Komandë. Këtë e bëra kësioj: lëshova Memishin, më duket se me 14-15 veta që të futet në komandë, të shpërndarë nëpër korridore. Tahiri e rrethakoi komandën, duke i vendosur njerëzit nëpër skaje të rrugës në afërsi prej

50-100 metrash, në mënyrë që të mund të mbrohen nga ndonjë sulm eventual.

Unë me oficerët dhe Arifin shkuam në komandë, për fatin tonë, në momentin kur Mehdi Frashëri në konferencë me delegatët që sulmuar me top nga ana e LNÇ-së. Gjenerali Prenk Previzi më pranoi, ishte nervoz, por u përmbajt.

“Si është ajo që mos ta dorëzosh batalionin. A e di se do më detyrosh të ndërmarr operacion, ti nuk je ushtar!”

“Nuk e dorëzoj batalionin”, i thashë “për faktin se nuk je njeri i fjalës, nuk ke singëritet, aspak nuk ke qëndruar në atë çfarë ke premtuar, nuk mund të ndërmarrësh operacion kundër atyre që të kanë ardhur deri në prag të derës, të cilët pamëshirshëm gjuajnë me topa e do të ndërmarrësh operacion kundër meje, unë jam këtu për të të parë”.

I bie telefonit, e thërret adjutantit, majorin e artilerisë Filip Lezhën, mirëpo mua nuk më lëshon, duke m’u kërcënuar: “Mos lëviz, do të jesh i vvarë!”

Arifi iu drejtua: “Ti je në duart tona, a e sheh këtë!”

“Po çfarë mendon?”, mu drejtua mua, “Përse ke ardhur i armatosur?”

Iu përgjigja: “Të mos jem i flijuar nga vetë dëshira jote, sërish të kthehem prapa, ndërsa ti cakto njeri që t’i dorëzoj ushtarët, kuptohet ata që do të pranojnë të shërbejnë”.

“Mirë”, tha gjenerali, “unë do i ftoj”.

Ndërhyra unë: “Vetëm Neshat Kolonjën, për atë kam menduar”.

Me urdhrin e tij hyri Neshat Kolonja dhe deklaroi se do t’i pranojë së paku dy ushtar. Insistonte që unë të ngeli ndihmësi i tij, por e refuzova e as ushtarët nuk pranuan. Mund të them se pas kthimit nga Shkupi, Xhema në Gostivar dhe Komiteti në Tetovë kishin futur zjarr në mesin e

ushtarëve. Filloi ndërkëmbëza, ku thoshin: “Nuk dëshirojmë më të shërbejmë, le të vijë ndërrimi, do na dorëzosh në duart e huaja”, prandaj isha i detyruar të intervenoj në mënyrën më të fuqishme në çetën e parë në Gostivar dhe çetën III në Tetovë, e para nga togeri tashmë i vrarë Mexhait Gajra, e treta nga togeri, Yzeir Yzeiri.

I tërë intervenimi im qe bërë që të mos shpërbëhet, që të mund t’i tërhiqja kah vetja Gostivarin, Kërçovën e Strugën pjesërisht, mirëpo kjo nuk dha rezultate, prandaj pranova t’i dorëzoj ushtarët, le të jenë në numër të vogël.

Erdhi nënkoloneli, u takua me komitetin. Nëpër çeta krijohet revoltë. Unë u largova në shtëpi, zotërinjtë oficerë ngelën në shërbimin aktiv. I ftova të tërhiqemi në mal, ku do na bashkëngjiteshin edhe të tjerë. Atëherë, i pari refuzoi Arifi, me fjalët: “Gajur Bej, më duket se ti je komunist!”

E pyeta “përse i duket”, ai m’u përgjigj: “E para, për shkak se ne i ndjekim komunistët nëpër male, i dërgojmë në komandën e xhandarmërisë, qenë kapur rreth 24 grupe që mbanin lidhje me Tetovën, ty shkon i ftuar nga ata dhe të parin e liron Shaip Preshevën.

E dyta, më kujtohet mirë se kur u angazhove te vëllai yt, Hysen Beu, urdhërove që të përpiqen ta shpëtojnë prefektin e Dibrës, Mehmet Hoxhën nga Gjakova, vendi i të cilit tash më dihet se është në mal me partizanët jugosllavë. Dje ishte themelimi i batalionit, vetëm t’i urdhërove Nevzat Roshin t’i lirojë rrugë Fadil Hoxhës dhe ai shpëtoi.

E treta, mu në momentin kur qe bllokada, t’i e urdhërove togerin Yzeir Yzeirin të kujdeset të mos bëjnë krime ushtarët. “Mos shikoni në një, dy apo dhjetë topa”, këtë e ke thënë ti në shtëpinë tënde se ka rezerva. Në veprimtarinë tënde, ti hasë në flamurin bullgar dhe nuk e dorëzove në nënprefekturë, por e dogje. Hysen Beu vret vullnetarin tonë, ti je mbrojtësi i tij”.

Mund të na thuash se edhe ne dimë, Arifin naiv e kanë mbushur mirë, e pashë. Kuptohet se iu përgjigja: “Hysen Beu vërtet e bëri mirë që e ekzekutoi atë vullnetar, sepse me vjedhje, dhunim, nuk mund të arrihet asgjë. Përse është gjyqi, xhandarmëria, bashkia, komunat, policia e tjerë. Të stimulojnë njerëzit e çmendur, nën pretekst se nëna e nënës së tij ka lindur në atë shtëpi, dhe në mënyrë më brutale e dëbon nga shtëpia e saj një nënë të varfër, atëherë ku është shteti, kur nuk ndërmerret asgjë?”

“Bllokada e Tetovës vërtet ishte pardje, është e vërtetë se unë ashtu urdhërova dhe nuk e dorëzoja flamurin, aq më tepër urdhërova të digjet, sepse atë flamur e kishin përgatitur shumë më herët se të vijë Italia”.

“E këshillova Nevzatin dhe vëllanë tim Hysenin, që të lëshohet të arratiset dhe t’i shmanget lëkurës fashiste. Mehmet Hoxhën e mbrojtja për shkak se nuk dua që shqiptari të vritet nga shqiptari me urdhrin e të huajve, të dorëzohet në duart e të huajve. E shpëtova Shaip Preshevën, nëse nuk e di, ja po ta them: Urdhërova xhandarin ta nxjerrë Shaipin para kazermës së xhandarmërisë, kur unë isha i ftuar nga të burgosurit me ndërmjetësimin e një të riu nga organizata rinore. Arrita para kazermës, kur edhe Shaipi (Kamberi –Q. L.) me automobil arriti para meje, ndërsa nga ana e kundërt sillej Shaip Presheva. Kamberi pa u menduar fare zbriti nga automobili dhe u nis drejt kazermës. E ndala, dhe xhandarit i thash të ndalet, duke i thënë se punën e tij e kishte kryer, ndaj duhej ta linte në duart tona. Xhandari u përshëndet dhe largohet nga kishte ardhur, nga Çarshia e Epërme. Atij (Shaip Kamberit–Q.L.) i drejtohem: “Dëshiron ta dorëzohet te polici gjerman, je kryetar bashkie, patriot?”

Presheva përgjigjet: “Të lutem, nga ai nuk dua mëshirë!”

Kamberi, pa folur, fillo të qeshet dhe u largua. Unë e përcolla Preshevën deri te ura e Çarshisë së Epërme dhe ai shpëtoi. Kthehem në zyrë, ku

ishin Qazim Lusha, kapiteni i xhandarmërisë Hajdar Pllaneja dhe Shaip Kamberi. Posa e hapa derën, Shaipi më foli mua: “Mos u brengos, nesër të gjithë do të lirohen!”

Unë i nervozuar iu drejtova: “Dorëzoi, ndoshta më pas do të emërohesh ministër!”

Sherif Mina: “Këtë nuk e lejojmë!”

Të nesërmen të rinjtë, në krye me Vera Popovën, u liruan.

I njëjti ai Shaip (Presheva–Q.L.), pas kthimit të robërisë së njëjtë, mua më sulmoi për robërinë e tij, kur pjesërisht ia lexoi kryetarit të gjyqit, Panta Marinës. Nga ai grup i të rinjve që u liruan të nesërmen, më akuzoi Adam Kriçi dhe ortodoksi, emrin ia kam harruar, që ky i fundit më akuzoi në gjyq se kam pas sjellje brutale ndaj tij, të cilit gjoja ia paskam thyer dorën të cilën edhe sot e ka të shëndoshë (vërejtja e Gajur Derallës dhënë organeve të hetuesisë).

“Shpëtoje njeriun që të t’i nxjerr sytë!”, tash mund të them, unë i shpëtova apo i shpëtoi i pushkatuari Shaip (Kamberi–Q.L.), i cili gjithashtu qe sulmuar në gjykimin e tij, si nga Shaip Presheva, ashtu edhe nga grupi i Verës (Tetovës –Q. L.), i cili i shpëtoi nga kamxhiku gjerman që të mos intervenohet. Unë prandaj them, se atëherë nuk kam pasur kurrfarë fuqie, përveç asaj morale, batalioni qe dorëzuar, nënkoloneli insistonte që ai grup të dënohet, gjithashtu këtë e shprehte edhe xhandarmëria, unë vetëm insistova që të lirohen, të mos dorëzohen në duart e gjermanëve, por Shaip Kamberi dhe Sherif Mina këtë e bënë, të nesërmen u liruan. Unë edhe sot e them, i thash atëherë Arifit, se është bërë mirë që janë liruar, nëse asgjë tjetër për një lëvdatë”.

Arif Dragomanca: “Përderisa bullgarët i merrnin vëllezërit tanë dhe i dërgonin në Simitli, ti i thoshe kolonelit Ali Shefqet Shkupi që të lirohen të gjithë ata që janë tubuar nga bullgarët e këtushëm”.

Iu përgjigja: “Unë nuk dua, por nëse ti u shërben gjermanëve, shko dhe lajmëroi!” Kuptohet se tha, jo.

Pas disa ditëve, nënkoloneli Neshat Kolonja mori urdhër që mua të më dërgojë në Tiranë, me një testament prej 200 ushtarësh. Këtë unë e refuzova dhe në vend timin shkon Vehap Daci, ko-komandant i Detachmentit. Atje që rrethakuar brenda qytetit nga partizanët. Pas një lufte prej 48 orësh, ku luftimet u zhvilluan në hotelin e madh përballë liqenit, i plagosur rëndë i dorëzohet partizanëve, të cilët i pushkatuan të gjithë oficerët. Në këtë kohë, gjermanët vetëm se kishin ardhur në Tetovë dhe kryenin përgatitje për mobilizimin e Divizionit SS “Skënderbeu”.

Pas vrasjeve në Pogradec, partizanët i lirojnë ushtarët, të cilët të zhveshur e të zbathur arrijnë në shtëpitë e tyre. Komanda urdhëroi të merret Preseku dhe unë nga Tetova të shkoj në Presek, ku të nesërmen pa asnjë arsye e kthej batalionin në Kërçovë. Gjysma largohen nëpër shtëpitë e tyre, gjysma ngel. Atëherë rreth 150 sish ngelën me nënkolonelin dhe me Hilmi Miletinën, i cili, pas largimit tim, bëhet më i afërmi i nënkolonelit Kolonja dhe u gradua në gradën kapiten i klasit II. Mirëpo, gjermanët në Kërçovë nuk pranojnë që ajo pjesë e ngelur të futet në aksion, nëse do t’i jepej mundësia, kuptohet me qëllim të krijimit të Divizionit SS “Skënderbeu” dhe, duke i çarmatosur ushtarët, neve oficerëve na internuan për në Prishtinë, ku shkuam përmes territorit bullgar: Kaçanik – Ferizaj - Prishtinë, duke na ndarë në dy pjesë. Mua, me disa të tjerë, më dërguan në Ferizaj, ndërsa Hilmi Miletinën me të tjerët, ku ishte edhe togeri Nazif Izet Aliu, në kishën e Graçanicës.

Pas 5 ditëve, unë qesh ftuar për raport te ndonjë komandant gjerman, së bashku me Neshat Kolonjën, ku prezent ishte edhe Fuat Asllan Dibra, që të tregojmë përse batalioni është shpërbërë. Nënkoloneli përpiquej të arsyetonte veten se ai është i huaj për ata ushtarë, por kur më pyetën mua, u thash si vijon: “Që në fillim e di se nuk do më besoni. Batalionin e keni shpërbërë ju, që të krijoni Divizionin “Skënderbeu”, nën

komandën e oficerëve tuaj, se e keni përdorur jashtë kufijve tanë dhe si pararoje e tërheqjes suaj. Këtë kuptohet se e dinë ushtarët, sepse është një e vërtetë e dukshme, kurse unë nuk do të doja të jem pararoje. Unë mendoj se jeni të vetëdijshëm se këtu nuk do të mund të bëni atë që e keni bërë në vendet e tjera”.

Profesor Gashi (Luan Gashi–Q.L.), drejtor i Gjimnazit të Prishtinës, i cili mori pjesë me dëshirën e tij, ndërhyri: “Zoti Gajur, gjermanët ta kenë të qartë këtë, këtu nuk është Kragujevci!”

Gjermanët u ngritën. Pas 24 orëve erdhi urdhri për ndarje në dy grupe, shkuam në Graçanicë dhe Ferizaj.

Mund të vë në pah se menjëherë pas internimit tonë në Prishtinë arriti një delegacion i përbërë nga Baba Qazimi, Nexhmedin Besimi dhe Sherif Mina, për të intervenuar në lirimin e oficerëve, duke i lutur gjermanët se do ta përmirësojnë gjendjen tek përkrahësit e tyre më të afërt dhe nëse është e mundur edhe në popull.

E di se kanë dashur të shkojnë te prefekti i Prishtinës, Hysen Prishtina, duke më ftuar që të shkoj me ta. Nuk kam dashur dhe ai nuk i pranoi. Me ndërmjetësimin e komandantit të Divizionit I, kolonel Fuat Asllan Dibra, qenë pranuar nga komandanti gjerman, ku thuhet se ata kanë vepruar për lirimin e internimit të parë /këtë më së miri mund ta dijë Nexhmedin Besimi/.

Përmes Sharrit u kthyem në Tetovë. Menjëherë pas lirimit, pas 15 ditëve, neve dy vëllezërve sërish na kthejnë në internim në Vjenë /Austri/, ku jemi detyruar në punë të rënda fizike, prej nga kthehemi më 10 mars 1945. Paraqitemi në kampin privat në Novi Sad, te shkolla Zora Lazar. Nga aty qesh dërguar në kampin e oficerëve në Pançevë, ku ishin më shumë se 100 ish-oficerë jugosllav, në mesin e tyre edhe kolonel Jeremi Iliq, i njohur si Jasha Disiplina, koloneli i Shtabit të Përgjithshëm Petroviq. Pas një muaji, vetëm mua më dërguan në burgun e Beogradit, në dhomën nr. 16, në podrum.

Për herë të parë jam marrë në pyetje nga Prokurori Publik i procesit të Drazha Mihajloviqit, emrin ia kam harruar. Që atëherë kam deklaruar se kam qenë oficer dhe se i kam shërbyer ish-Armatës Jugosllave, ndërsa më vonë përmes rrugës legale kam shkuar në Shqipëri, prej nga vetë jam kthyer. Nuk kam më çfarë të shkruaj!

Ngeli me nderime,

Nga i burgosuri G. Deralla s.r.790

---

<sup>790</sup> ДАРМ. Ф. УДБ-РСВР. Д. 42010645, МОЈЕ КРАТКО КОМАНДОВАЊЕ БАТАЛЈОНОМ АЛБАНСКИХ РЕДОВНИХ ТРУПА, ПОСЛЕ КАПИТУЛАЦИЈЕ ИТАЛИЈЕ.